



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË

TEMA E MAGJISTRATURËS:

“TERRORIZMI NGA PIKËPAMJA E PSIKOLOGJISË KRIMINALE”

KANDIDATI:

SHPEND DOBROSHI

TETOVË, 2022

MENTOR:

Prof. BLERTA Ahmedi ARIFI



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

DEKLARATA E ORIGINALITETIT/AUTORËSISË

Unë, Shpend Dobroshi, student i Masterit në Universitetin e Europes Juglindore, fakulteti i drejtësisë, drejtimi Studime të Sigurisë, deklaroj se ky punim diplome është tërësisht autentik dhe origjinal. Literatura dhe burimet e tjera të informacionit, prej nga jam bazuar, janë të bazuara në referenca dhe janë të cituara.

Punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveçse siç deklarohet në brendi të tekstit.

Data/Datë: _____ 2022

Shpend Dobroshi

Nënshkrimi/Signature

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Për hartimin dhe përfundimin e kësaj teme diplome kanë kontribuar shumë persona. Si fillim, dua ta falenderoj familjen për mbështetjen e pandërprerë që nga fillimi dhe këshillën e tyre për të vazhduar në këtë drejtim

Së dyti, dua të falenderoj Universitetin e Evropës Juglindore dhe gjithë stafin profesional për njohuritë dhe kontributin e tyre në formimin tim, si në aspektin kognitiv ashtu edhe në mundësinë e dhënë për implementimin e njohurive në praktikë.

ABSTRAKT

Terrorizmi është një problem që ka prekur çdo shoqëri duke e shndërruar në një problem global, prej të cilit vështirë mund të iket. Prandaj kur ballafaqohemi me probleme të tilla të cilat nuk mund t'i zhdukim, dorëzimi nuk është asnjëherë zgjidhja e problemit sepse atëherë edhe do të dështojmë. Ajo çfarë bëhet në këtë rast është qasja e problemit nga një aspekt tjetër.

Edhe pse në fillim ishte shumë qasje skeptike dhe e luftuar nga sistemi i pranishëm që ishte në në 30 vitet e fundit, përsëri kjo qasje nuk u la anash dhe me kalimin e viteve arriti që të fitojë terren të rëndësishëm në zgjedhjen dhe kuptimin e problemit të terrorizmit.

Qasja psikologjike ndaj krimit nuk filloi me problemin e terrorizmit, ajo gjenezën e saj e ka me kuptimin e kriminelëve të dhunshëm të cilët me krimet e tyre tronditën botën dhe sidomos gjatë viteve 1970/1990 kriminaliteti ishte shumë i zhvilluar, por edhe brutal. Prandaj ishte shumë e nevojshme që të analizohej edhe vetë autori i krimit, me synimin për të kuptuar arsyen e vërtetësisë se pse një person kryente një akt të tillë.

Këto njohuri që u zhvilluan dhe u përsosën me kalimin e viteve gradualisht filluan të implementohen edhe te zbulimi dhe trajtimi i terrorizmit.

Tash ekzistojnë departamente të veçanta në çdo shtet që luftojnë terrorizmin, por në të njëjtën kohë falë njohurive të fituara ndër vite ata edhe në shumë raste arrijnë të parandalojnë sulme të tilla falë psikologjisë kriminale dhe elementeve tjera.

Fjalet Kyçe: Terrorizëm, psikologji, kibernetikë, armët e shkatërrimit në masë, konflikt, rrezik.

PËRMBAJTA

Hyrje.....8-9

Vështrimi historik i Terrorizimit

Kapitulli I

1. HISTORIKU I TERRORIZMIT DHE PËRKUFIZIMI I TIJ.....10-14

1.1. Gjenezja e sulmeve terroriste.....14-29

Definicioni dhe analizë e thjeshtë, Historiku i sulmeve terroriste, Hashashinët, Terrorizmi fetar, Çfarë është feja, Sakrificja, Procesi i rekrutimit, Shpërlarja e trurit, Propaganda.

1.2. Lufta kundër sulmeve terroriste në periudha të ndryshme.....29-31

1.3. Periudha e artë e Terrorizmit.....31-35

1.4. Hartimi i planeve dhe strategjive shtetërore.....36-39

SHBA, Britania e Madhe, Përkufizimi i terrorizmit sipas legjislacionit ndërkombëtar

Kapitulli II

2. KONTEKSTI PSIKOLOGJIK.....40

2.1. Hyrje në psikologjinë forenzike (kriminale).....41-43

2.2. Analiza e faktorëve sociologjikë, psikologjikë.....43-52

Hipoteza mbi frustrim-agresionin, Hipoteza e identitetit agresiv, çrregullimet e personalitetit, Karakteristikat sociologjike të terroristëve në periudhën e luftës së ftohtë, Moshja, Statusi martesor, Gjinia.

2.3. Analiza e faktorëve ekonomikë dhe kulturorë.....52-56

2.4. Analizë e sulmeve të ndryshme terroriste nga konteksti psikologjik.....56-57

Kapitulli III

3. RËNDËSIA PSIKOLOGJIKE E TERRORIZMIT.....58

3. 1. Rëndësia e psikologjisë në fushën e krimit.....58-62

3.2.Rëndësia e psikologjisë në shfaqjen dhe ekzekutimin e akteve të ndryshme terroriste.....62

3.3. Ndikimi i mediave në perceptimin e kërcënimit të terrorizmit.....63

Kapitulli IV

4. E ARDHMJA.....64-65

4.1. Evoluimi i sulmeve terroriste.....65-66

4.2. Teknologjia dhe Terrorizmi.....66-71

4.3. Terrorizmi dhe Krimi i Organizuar.....72-76

Përfundim.....77

Rekomandime.....78

Literatura.....79-81

HYRJE

Shpesh në sipërfaqe një problem duket që është shumë i thjeshtë dhe si rrjedhojë ai keqkuptohet dhe nuk i kushtohet vëmendja e duhur nga fillimi. Është ky iluzion që ka krijuar një mit rreth terrorizmit dhe vetë historisë së tij.

Nëse e pyesim secilin person se çfarë mendon për terrorizmin dhe çfarë konsiderojnë ata si kërcënim serioz nga terrorizmi, shumica e tyre për mos të thënë te gjithë, do të përgjigjen:

-Al Qaeda

-ISIS

-Fundamentalizmi Islamik

-9/11

-Talebanët

Kjo tregon se informacionin që e konsumon popullata e gjerë nga burimet e informacionit, informacion të cilin e merr si të saktë dhe të vërtetë dhe nuk e vë në dyshim për asnjë moment.

Burimet e informacionit nuk kufizohen vetëm në ato tradicionale si TV dhe Radio, sepse këto forma kanë kohë që kanë kaluar në plan të dytë.

Bëhet fjalë për internetin dhe rrjetet sociale të cilat deri vonë nuk kanë qenë të rregulluara në aspektin e vërtetësisë së informacionit. Vetëm në vitet e fundit kemi qenë dëshmitarë të disa veprimeve të ndërmarra ndaj kompanive që ofrojnë këto shërbime, të cilat del që nuk janë dhe aq efektive, për të mos thënë fare.

Mund të shtrohet pyetja se përse me fillim hapet tema për teknologjinë, kur tema në fokus ka terrorizmin.

Është më e thjeshtë nga sa mendohet.

Për të kuptuar në thelb një problem i çfarëdo natyre qoftë ai, duhet shqyrtuar informacionin sa më të saktë dhe më të papërmirësuar dhe redaktuar, ose thënë më qartë, informacionin e pafiltruar.

Ky qëllim është i mundur vetëm duke marrë si burim të informacionit gjithë materialin e mundshëm që nga kohët më të vjetra dhe duke analizuar ngjarje të ndryshme të cilat kanë pasur elemente të terrorizmit.

Nuk duhet harruar që termi “TERRORIZËM” ekziston vetëm nga shekulli i 18-të, por kjo nuk e mohon në asnjë mënyrë faktin që ngjarje me karakter terrorist kanë ndodhur më parë në të kaluarën.

KAPITULLI I

1.HISTORIKU I TERRORIZMIT DHE PËRKUFIZIMI I TIJ

1.1 Gjenezat e sulmeve terroriste

Përkufizimet e terrorizmit janë zakonisht komplekse dhe të diskutueshme dhe për shkak të egërsisë dhe dhunës së natyrshme të terrorizmit, termi në përdorimin e tij popullor ka zhvilluar një stigmë të fortë. Ajo u krijua për herë të parë në vitet 1790 për t'iu referuar veprimeve të përdorura gjatë Revolucionit Francez nga revolucionarët kundër kundërshtarëve të tyre. Partia jakobine e Maximilien Robespierre kreu një mbretërim terrori që përfshinte ekzekutime masive nga gijotina. Megjithatë terrorizmi në këtë përdorim nënkupton një akt dhune nga një shtet kundër armiqve të tij të brendshëm, që nga shekulli i 20-të termi është aplikuar më shpesh për dhunën që synon, drejtpërdrejt ose tërthorazi, qeveritë në një përpjekje për të ndikuar politikën ose për të rrëzuar një regjim ekzistues.¹

Ndërsa është e pamundur të përcaktohet përfundimisht se kur është përdorur për herë të parë, ajo që ne sot e quajmë terrorizëm i ka rrënjët e saj të paktën rreth 2000 vjet më parë. Për më tepër, terrorizmi i sotëm, në disa aspekte, ka bërë rrethin e plotë, më shumë nga praktikuesit e tij bashkëkohorë të motivuar nga bindjet fetare – diçka që i shtyu shumë nga paraardhësit e tyre më të hershëm. Gjithashtu, në përdorimin e pranuar përgjithësisht të fjalës, shpesh ka pasur një dimension politik. Kjo ka ngjyrosur pjesën më të madhe të diskursit që rrethon terrorizmin - një fenomen i cili, sipas Paul R. Pillar, është 'një sfidë për t'u menaxhuar, jo për t'u zgjidhur.

Vrasje të tilla zakonisht kryheshin në dritën e ditës dhe para dëshmitarëve, me autorët që përdornin akte të tilla për t'u dërguar një mesazh autoriteteve romake dhe atyre hebrenjve që bashkëpunuan me ta - një taktikë që do të përdorej edhe nga brezat pasardhës të asaj që do të bëhej e njohur si terroristë.

¹<https://www.britannica.com/topic/terrorism>

Adhuresit e feve të tjera iu drejtuan gjithashtu metodave që sot mund të quhen terrorizëm, siç janë vrasësit - një degë e shekullit të 11-të e një sekti mysliman shiit të njohur si Ismailitë.²

DEFINICIONI

Edhe pse nuk kemi një definicion universal mbi terrorizmin për shkak të këndvështrimit, në përgjithësi kemi një bazë e cila prapë se prapë është e mangët.

Sipas mendimit tim të bazuar në vite studimi në fushën e sigurisë do ta përkufizoja kështu:

“Terrorizmi është një akt dhune që është i motivuar politikisht, i cili ka për qëllim krijimin e një fryme pasigurie, ngjallje të panikut, krijim të destabilitetit ekonomik, shoqëror dhe politikë “

Shumica e shteteve përdorin termin "terrorizëm" vetëm për aktorët joshtetërorë, por, në mënyrë disi të parëndësishme, disa prej tyre, veçanërisht Shtetet e Bashkuara, bëjnë një përjashtim kur ai aktor joshtetëror "sponsorizohet" nga një shtet i huaj. Një nga të anketuarit tanë (C. Fair) u kundërshtua me faktin se përkufizimi i Departamentit të Shtetit të SHBA-së nënkupton se "terrorizmi është kompetencë e aktorëve joshtetërorë". Ajo shton:

Ai gjithashtu liron shtetet nga çdo përgjegjësi për rolin e tyre në zhvillimet terroriste brenda kufijve të tyre dhe më gjerë. Ai gjithashtu zvogëlon hapësirën për komunitetin ndërkombëtar që t'i mbajë përgjegjës shtetet represive, edhe pse i mban grupet militante për të njëjtën përgjegjësi. Unë do të argumentoja se kur shtetet përdorin terrorizmin, sfida morale është edhe më e madhe për shkak të detyrimit të tyre për të mbrojtur qytetarët e tyre. Ky përkufizim gjithashtu duket qartë se i shërben në mënyrë specifike interesave të SHBA-së.³

Ajo që e dallon një ushtar nga një kriminel lufte është se ushtari e bën dallimin vendimtar midis luftëtarëve dhe joluftëtarëve (si të burgosurit e luftës dhe ushtarët e armikut të

²<https://www.pogo.org/investigation/2015/02/brief-history-of-terrorism/>

³ The Routledge Handbook of Terrorism Research by Alex P.Schmid (2011,faqe 48)

plagosur) dhe civilë. Ajo që e dallon një luftëtar kryengritës nga një terrorist nuk duhet të jetë ndryshe.

Terroristi nuk zgjedhë se cilin person apo grup do të sulmojë, ai madje mund të targetojë një grup tërësisht të pafajshëm dhe të terrorizojë popullin e gjerë me mesazhin drejtuar një individ apo grupi të caktuar, sepse duke mos qenë në gjendje që të sulmojë drejtëpërdrejtë, ai grup tenton që mesazhin e tij ta japë përmes viktimave që mund të përfaqësojnë diçka shumë të rëndësishme për individin apo grupin e caktuar.

Vetëm analiza e këtij përkufizimi do të konsumonte kohë të gjatë siç edhe u ka marrë shumë ekspertëve para nesh dhe rezultati në fund është ky që sapo u tha, pra, nuk kemi një përkufizim universal.

Arsyeja e parë: Akti i dhunës, për të cilin e dimë që kemi forma të ndryshme të dhunës jo vetëm ajo fizike ,sepse sidomos në kohët moderne, shkenca e trurit është duke shpërthyer sa i përket interesit të studimit, por edhe të arriturave të reja të cilat kanë hedhur dritë mbi mënyrën se si funksionon njeriu, sepse tek e fundit është truri ai që e bënë një individ njeri. Janë ato procese që ndodhin në tru që përcaktojnë mënyrën se si do të veprojë një person.

Në disa situata të caktuara është vërtetuar që truri i njeriut pa marrë parasysh moshën, gjininë, racën në situata të cilat paraqesin rrezik për jetën e njeriut, truri i njeriut ose për të qenë sa më korrekt, truri kafshëror ose ndryshe që njihet si truri limbik, i cili është përgjegjës për veprimet me karakter emocional dhe jologjik.

Në raste të kërcënimit ekstrem, truri i njeriut gjatë evoluimit mijëra vjeçar, ka zhvilluar disa forma që nuk dallojnë nga asnjë njeri. Kjo procedurë njihet si:

- Ngrijë
- Vrapo
- Lufto

-Ngrijë: Truri i njeriut gjatë miliona viteve evoluim, ka zhvilluar disa instikte bazë mbijetese që e kanë ndihmuar në përballimin me shumë rreziqe dhe kërcënime. Nuk është çudi që duke qenë se njeriu futet në grupin e gjitarëve, sjellje të ngjajshme të shohim edhe te shtazët tjera, madje disa e kanë perfeksionuar deri në atë nivel sa që arrijnë të kamuflohen tërësisht me ambientin përreth, siç është rasti i kameleonit.

Ky lloj reagimi është ndër më të hershmit dhe konsiderohet si hapi i parë i reagimit. Por mund të pyesim se çfarë tentojmë të arrijmë me këtë reagim dhe përgjigja është shumë më e thjeshtë se që mendohet.

Me anë të këtij reagimi njeriu mundohet që të jetë sa më i qetë në mënyrë që të mos tërheqë vëmendjen e kërcënuesit. Shumë shembuj të tillë ndeshen nga dokumentarët e shumtë për botën e egër dhe momentet kur protagonistit pikaset nga një kafshë e egër, ku vërehet që reagimi i parë do të jetë ngrirja në vend, duke kufizuar në maksimum lëvizjet dhe duke e zvogëluar sa më shumë që është e mundur ritmin e frymëmarrjes.

Vetëm në momentin kur kjo ndërmarrje nuk është e mjaftueshme dhe shihet që rreziku po afrohet, atëherë truri i njeriut fillon që të lëshojë sinjale të cilat ngrisin në maksimum nivelin e gatishmërisë në muskuj, duke ngritur në maksimum kapacitetin e trupit njerëzor për t'u përballur me kërcënimin në forma që në gjendje normale shpesh është e pamundur. E gjithë kjo është e mundur falë nivelit dhe sasisë së adrenalinës që pompohet në gjakun tonë dhe që shërben si një lloj katalizatori i proceseve psiko-fizike.⁴

Në shumicën e rasteve dy hapat e parë janë të mjaftueshëm për të evituar rrezikun dhe nuk është nevoja për të proceduar me hapin përfundimtar, i cili është "Luftimi".

Atëherë kur jemi me shpatulla të mbështetura për muri dhe të gjitha rrugët na janë shterruar, atëherë jemi gati që të luftojmë me qëllimin e vetëm, mbijetesën.

⁴<https://www.healthline.com/health/mental-health/fight-flight-freeze>

Janë këto disa procese shumë të thjeshta, por të cilat do të na ndihmojnë shumë në kuptimin e thelbit të temës që kemi vendosur të shtjellojmë. Duke qenë që baza është formuar, atëherë padyshim që hapi i dytë për elaborim më të gjerë hapet automatikisht.

HISTORIKU I SULMEVE TERRORISTE

Mungesa e definicionit që u sqarua në paragrafin paraprak nuk nënkupton që dukuria si dukuri nuk ka ekzistuar më parë, por thjesht nuk kemi ditur se si t'i qasemi dhe ta trajtojmë.

Nuk duhet lënë pa përmendur ndikimin e mediave në keqkuptimin e definicionit mbi terrorizmin, sepse ajo është shumë e gabuar dhe ndikon negativisht në studimin e problemit.

Sa i përket terrorizmit është shumë e rëndësishme të cekem disa vija të kuqe të cilat asnjë person nuk është mirë që t'i kalojë ose t'i keqkuptojë e aq më pak studiuesit e fushës së sigurisë.

Fenomeni i terrorizmit ka qenë prezent edhe para datës 11 shtator 2001, e vetmja hallkë që ka munguar ka qenë interesi për studimin e problemit në nivel edukativo-akademik.

Ndër rastet më të vjetra të dokumentuara të sulmeve terroriste ose pararendësve të tyre mund të konsiderohen sulmet e grupeve të vogla fisnore që ishin ende nomad dhe pa një vendbanim të përhershëm. Këto sulme karakterizoheshin nga befasia, sidomos gjatë natës dhe kishin për qëllim frikësimin e kundërshtarëve, me qëllim që t'i largonin ata nga burimet natyrore dhe kullotat e egra.

Të kujtojmë që këto grupe nuk kishin një vendbanim të përhershëm dhe ishin gjithmonë në kërkim të furnizimeve të reja. Duke qenë se në shumë raste numri i burimeve të ushqimit ishte i kufizuar, rrjedhimisht edhe konkurrenca ishte shumë e madhe.

Sulme të tilla i dokumentojmë edhe në kohën e udhëheqësit të madh Genghis Khan i cili sundoi me dorë të hekurt por edhe me shumëzgjuarësi. Edhe pse në kohën kur sundonte ai këto forma nuk njiheshin me emrin terrorizëm ngaqë në përgjithësi jeta politike nuk ishte e zhvilluar, përsëri

qëllimi ishte i njëjtë, krijimi i destabilitetit, ngjalljes së frikës dhe panikut, të cilat janë kushte për sulmin terrorist modern.⁵

Ose nëse dëshirojmë të jemi pak më koherent dhe të pikasim gjenezën e formës së sulmeve terroriste që kemi sot, mund të flitet për shekullin 11 dhe për grupin e famshëm që në ditët e sotme njihen si Kredoja e Vrasësve nga e cila ngjarje janë frymëzuar edhe filma dhe lojëra shumë të sukseshme.

Por e vërteta dallon pak nga industria e argëtimit dhe kjo fillon që nga emri.

“HASHASHINET”

Hashashinët ose ndryshe njohur edhe si urdhëri i vrasësve ishin grupe vrasësish që ekzistuan gjatë shekujve XI, XII & XIII.

Duke u bazuar në librin Sipas Saladinit dhe Rënies së Mbretërisë së Jeruzalemit, Hashashins (arabisht dhe persisht për "vrasësit") kanë origjinën në 1094 në Siri (dhe ajo që tani është Irani verior) nën udhëheqjen e Hassan-i Sabbah, një udhëheqës popullor dhe i mirënjohur, i cili respektoi myslimanët shiitë, në mënyrë që të rrëzonte armiqtë e tij në mes të trazirave fetare dhe politike në Tokat e Shenjta.

Për shkak të statusit të tij të lartë, Sabbah kishte pak probleme për të fituar ndjekës serioz. Si rezultat, nuk kaloi shumë kohë pas vendosjes në Alamut që Hashashinët filluan të përdorin agjentë të spiunazhit dhe vrasjeve për të fituar një bazë politike dhe për t'i eliminuar kundërshtarët kyq. Këto veprime hapën rrugë për zgjerim të menjëhershëm pas kësaj.⁶

Vlen që t'i kushtohet vëmendje një pjese të veçantë në paragrafin paraparak.

“Filluan të përdorin agjentë të spiunazhit dhe vrasjeve për të fituar një bazë politike dhe për t'i eliminuar kundërshtarët kyq.”⁷

⁵ Gehghis Khan dhe krijimi i botes modern-Jack Weatherford,2019

⁶Lane-Poole, Stanley. (1906) Saladini dhe Rënia e Mbretërisë së Jeruzalemit. G.P. Bijtë e Putnamit.

⁷Nowell, Charles. (1947) Plaku i Malit. Shtypi i Universitetit të Çikagos.

Kjo mund të duket me tepër si një grup mercenarësh të cilët kryen vrasje të porositura, por qëllimi tregon se ky grup ishte shumë i organizuar dhe caktimi i viktimmave ishte i analizuar mirë, dhe mund të themi që vetëm ky mund të jetë dallimi në mes grupeve terroriste të gjeneratës së re dhe asaj të vjetër, sepse personat e pafajshëm nuk e pësonin tek grupet mesjetare, ndërsa sot kjo gjë ndodh.

Sipas Plakut të Malit, vetëm më të mirët nga më të mirët u bënë vrasës. Anëtarët përgjegjës për kryerjen e vrasjes ishin trajnuar gjerësisht, jo vetëm për të qenë mjeshtra të luftimit, por edhe për të qenë zotërues të mendjes.⁸

Mund të keni dyshimet tuaja në fillim se si një grup vrasësish profesional mund të merren si shembull i gjenezës së sulmeve terroriste.

Vetëm të mendohet se çfarë organizimi dhe çfarë qëllime të qarta kishte ky grup dëshmojnë se sa efikas dhe të rrezikshëm ishin. Të fokusohesh te pika mentale (psikologjike) e mjeshtrimit të atij arti dhe kjo vetëm në shekullin e 11, është një gjë e mahnitshme.

Të njejtën formë të praktikimit dhe funksionimit kanë edhe grupet terroriste në ditët e sotme, sidomos ato fushëveprime në Lindjen e Mesme. Shtete si Pakistani, Afganistani, Jemeni, Irani që janë të njohura si vatra të terrorizmit.

Interesant është fakti që këto grupe që rekrutojnë persona normalisht jo me aq rigorozitet sikur hashashinët, përsëri kanë një të përbashkët.

PËRDORIMI I HASHASHIT

Hashashinët nga dhe thuhet që e kanë marrë emrin si rrjedhojë e përdorimit të kësaj droge, e cila i ka çuar në një nivel tjetër të vetëdijes çka edhe ka ndikuar në mënyrën se si kanë vepruar. Dihet që drogat e sidomos hashashi janë droga që kanë ndikim në funksionimin e trurit.

⁸Nowell, Charles. (1947) Plaku i Malit. Shtypi i Universitetit të Çikagos.

Ndërsa në ditët e sotme grupet ekstremiste me anë të indoktrinimit që nga moshat e reja, si hap përfundimtar para se një person ta kryejë një akt terrorist, i japin hashash (Mariuhana).

Por nuk duhet keqkuptuar që përdorimi i drogës lidhet direkt me kryerjen e akteve terroriste sepse ka shumë përdorues të drogës, të cilët nuk kanë marrë pjesë në organizime dhe sulme me karakter terrorist.

Droga përdoret si hapi i fundit.⁹

Hapi i parë, siç edhe u cek më lart, është përhapja e informacionit.

Cilli është qëllimi?

Cili informacion?

Kujt i dedikohet ky informacion?

Pa dyshim që këto do të jenë dy pyetjet e para që do t'ju vijnë në mendje dhe padyshim që janë dy çelësat kryesorë për zbërthimin e problemit të një fraksioni të terrorizmit e që për shkak të rrethanave gjeopolitike të tanishme, është terrorizmi me karakter fetar.

Këto pyetje na dërgojnë vetëm në një drejtim dhe ai është shpërlarja e trurit ose siç jemi mësuar më shumë, indoktrinimi i njerëzve.

Shpërlarja e trurit ka një sërë aspektesh që mund të ndahen. Si dhe funksionin e tij politik si term abuzimi, ai mund të përdoret edhe si funksional përshkrimi i një procesi ose procesesh shkencore për arritjen e një kontrolli të tillë.¹⁰

Pra, qëllimi është i qartë, shpërlarja e trurit me synimin që një person të mendojë që veprimet që i kryen me qëllime të mira dhe dëmi që do të shkaktojë është shumë i vogël në krahasim me madhësinë e veprës së tij hyjnore.

Sa i përket pyetjes së dytë se cili informacion është vetë arti i manipulimit dhe shpërlarjes së trurit, kjo për faktin se zgjedhja e këtij informacioni ka vlerë jetike për suksesin e misionit. Nuk ka

⁹Në bazë të eksperiencës personale në shërbimet që kam kryer në Lindjen e Mesme

¹⁰ The Psychology of Criminal Behaviour and Anti Social Behaviour. Victim and offender perspectives-Wayne Petherick & Grant Sinnamon

mundësi që një personi t'i flasësh për natyrën dhe më pas ai të kryejë një akt terrorist. Gjuha dhe fjalët të cilat përdoren janë të zgjedhura dhe gjithashtu edhe personi që e përhap informacionin është i zgjedhur.

TERRORIZMI FETAR

Si nacionalizmi ashtu edhe feja kanë qenë shkëndijat e shumë luftërave të përgjakshme. Janë këto dy arsye që shumë kombe janë shuar dhe shumë të tjera janë krijuar.

Është më interesant që të bëhet dallimi në mes luftës dhe terrorizmit, sepse mund të haset në keqkuptime.

Ndër përkufizimet që i bëhen terrorizmit është se është arma e të dobët, sikur historia e Davidit dhe Goliathit, vetëm se në këtë rast Davidi mitizohet si një hero që arrin ta mposht një kundërshtar shumë më të fuqishëm.

Një fakt interesant është se sulmet me karakter nacional/fetar të kryera nga një shtet shumë rrallë për të mos thënë asnjëherë nuk emërohen si një sulm terrorist sepse kjo automatikisht do ta vinte në pozitën e të dobët, dhe shteti nuk duhet të qëndrojë përkrah të dobët.

Arsyeja se përse u fillua me shtetin është sepse të gjitha rregullat dhe ligjet i rregullon shteti, si rrjedhojë edhe fajësimi i shtetit do të ishte keq edhe për imazhin, andaj edhe fajësimi i entiteve ose grupeve më të vogla është më e lehtë. Nëse një shtet kryen një veprim të tillë ndaj një tjetri ai veprim automatikisht do të konsiderohet si një akt lufte që si pasojë në rastin më të mirë do të kishte ngrirje të raporteve dhe rastin më të keq luftë, dhe si për ironi njerëzit kanë zgjedhur shumë shpesh më përpara opsionin e dytë.

Gradualisht me shpalosjen e informacioneve dhe fakteve fokusi është zhvendosur nga niveli më i lartë, që është ai shtetëror, tek ai individual.

Bota në të cilën jetojmë është krijuar në atë mënyrë që çdo vendim dhe proces të udhëhiqet nga njeriu, si rrjedhojë njeriu është në qendër të çdo fenomeni dhe menaxhon me situata të

ndryshme dhe në raste të caktuara angazhon teknologji në mënyrë që puna e tij të lehtësohet, por që në fund vendimi i takon një njeriu.

Të gjithë këta njerëz jetojnë dhe veprojnë në bazë të personalitetit dhe intelektit që kanë brenda trurit të tyre. Prandaj, çelësi i çdo problemi njerëzor është vetë njeriu.

ÇFARË ËSHTË FEJA?

Besimi, raporti i qenieve njerëzore me atë që ata e konsiderojnë si të shenjtë, të shenjtë, absolute, shpirtërore, hyjnore ose të denjë për nderim të veçantë. Zakonisht konsiderohet gjithashtu se përbëhet nga mënyra se si njerëzit merren me shqetësimet përfundimtare për jetën e tyre dhe fatin e tyre pas vdekjes. Në shumë tradita, kjo marrëdhënie dhe këto shqetësime shprehen në termat e marrëdhënies ose qëndrimit të dikujt ndaj perëndive ose shpirtrave; në forma më humaniste ose natyraliste të fesë, ato shprehen në termat e marrëdhënieve ose qëndrimeve të dikujt ndaj komunitetit më të gjerë njerëzor ose botës natyrore. Në shumë fe, tekstet mendohet se kanë status shkrimor dhe njerëzit vlerësohen të kenë autoritet shpirtëror ose moral.¹¹

Feja është pra, në përshkrimin më të thjeshtë, besimi në diçka hyjnore, që është shumë më e madhe se njeriu dhe bota materiale. Ky lloj besimi ka ekzistuar gjithmonë.

Feja shpesh përfshin besime kulturore, botëkuptime, tekste, profeci, zbulesa dhe morale që kanë kuptim shpirtëror për anëtarët e besimit të caktuar dhe mund të përfshijë një sërë praktikash duke përfshirë predikimet, ritualet, lutjet, meditimet, vendet e shenjta, simbolet, ekstazat dhe festa.

Psikoanalisti i famshëm Sigmund Freud e përshkroi fenë si një formë të përmbushjes së dëshirave. Megjithatë, psikologjia moderne pranon se feja mund të luajë një rol të rëndësishëm në jetën dhe përvojat e një individi dhe madje mund të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien. Në fakt, studimet kanë treguar se feja mund t'i ndihmojë njerëzit të zhvillojnë zakone të

¹¹<https://www.britannica.com/topic/religion>

shëndetshme, të rregullojnë sjelljet e tyre dhe të kuptojnë emocionet e tyre - të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në shëndetin tuaj.¹²

SAKRIFICA

Sakrifica, një rit fetar në të cilin një objekt i ofrohet një hyjnie për të vendosur, ruajtur ose rivendosur një marrëdhënie të drejtë të një qenieje njerëzore në rendin e shenjtë. Është një fenomen kompleks që është gjetur në format më të hershme të njohura të adhurimit dhe në të gjitha pjesët e botës.¹³

Sakrifica ishte gjithashtu një element qendror i vrasjeve të kryera nga Thugees (të cilët na lanë trashëgim fjalën 'banditë') - një kult fetar indian që mbyti në mënyrë rituale viktimat e tyre (zakonisht udhëtarët e zgjedhur rastësisht) si një ofertë për perëndeshën hindu të terrorit dhe shkatërrimit, Kali. Në këtë rast, qëllimi ishte të tmerronte viktimën (një konsideratë jetike në ritualin Thugee) në vend që të ndikonte në ndonjë audiencë të jashtme.

Aktiv nga shekulli i shtatë deri në mesin e shekullit të 19-të, Thugees janë përgjegjës për deri në 1 milion vrasje. Ata ishin ndoshta shembulli i fundit i terrorizmit të frymëzuar nga feja derisa fenomeni u rishfaq pak më shumë se 20 vjet më parë. Siç thotë David Rapport: "Para shekullit të 19-të, feja ofronte të vetmet justifikime të pranueshme për terrorin." ë7] Motivimet më të shekullarizuara për veprime të tilla nuk u shfaqën deri në Revolucionin Francez, nga dhe e ka origjinin fjala terror e cila përdoret edhe sot e kësaj dite.¹⁴

Urrejtja ndërfaqetare nuk është diçka e re sepse është prezente që nga kohërat antike, madje ndër luftërat më të mëdha janë me karakter fetar, siç ishin Kryqëzatat.

Terrori në emër të fesë, terrori i shenjtë, është një histori e përsëritur.

¹²<https://www.verywellmind.com/religion-improves-health-2224007>

¹³<https://www.britannica.com/topic/sacrifice-religion>

¹⁴<https://www.pogo.org/investigation/2015/02/brief-history-of-terrorism/>

Një shembull i njohur i kësaj ishin zelotët hebrej të shekullit të parë, të njohur edhe si sicarii. Ky sekt vrasës ndihmoi në nxitjen e një kryengritjeje kundër pushtimit romak që rezultoi, ndër të tjera, në shkatërrimin e tempullit të dytë në vitin 70 të e.s. dhe diasporës.¹⁵

Te sekti Ismaili i njohur si Vrasësit ishte një ndërlidhës islamik. Për dy shekuj, midis viteve 1090 dhe 1272, ajo bëri vrasjen politike të dijetarëve myslimanë me teh, marka e saj tregtare.¹⁶

Terrorizmi fetar shihet nga praktikuesit e tij si një akt transcendental. I justifikuar nga autoritetet fetare, ai jep sanksion të plotë për aktorët që kështu bëhen instrumente të hyjnore. Numri dhe identiteti i viktimave nuk ka rëndësi. Nuk ka gjykatës më të lartë se shkak për të cilin terroristi e ka sakrifikuar veten.¹⁷

Terrorizmi është mbi të gjitha një mjet ose një teknikë. Kjo teknikë është po aq e vjetër sa vetë lufta, në kundërshtim me nocionin e përhapur që terrorizmi ishte pjellë e lëvizjeve nacionaliste të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Konfuzioni mund të jetë rezultat i shfaqjes së vonë të termit në Revolucionin Francez dhe terrorin e tij.

Ashtu si të gjitha fenomenet politike, terrorizmi përkufizohet nga dualiteti ndërmjet ideve të shpallura dhe zbatimit të tyre. Dhe, si të gjitha fenomenet politike, terrorizmi ekziston vetëm në një kontekst kulturor dhe historik.¹⁸

Por si ndodh që ky mentalitet të integrohet në mendjen e terroristëve është një art në vete.

Arma mbrojtëse dhe sulmuese e luftës psikologjike është propaganda, edukimi dhe provokimi. Municioni është informacioni në fjalë, letra, broshura, fotografi dhe email. Qëllimi është të binden njerëzit dhe t'i ndryshojë ata. Metoda është pastrimi i trurit.¹⁹

Kur dëshirohet që në trurin e njeriut të shtohet një dokument i ri, sistemi nuk është i njejtë si në kompjuter, siç është rasti me Microsoft Word, ku, nëse dëshirohet të përmirësohet ose fshihet komplet punimi, atëherë mjafton një e shtypur e butonit dhe puna përfundon.

¹⁵ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terroris-Rex A.Hudson(2002,faqe 27)

¹⁶ The History Of Terrorism from Antiquity to Al-Qaeda-Gerard Chailand and Arnaud Blinn

¹⁷ The History of Terrorism from antiquity to Al Qaeda-Gerard Chailand,Arnaud Blin (2007,

¹⁸ The History of Terrorism from antiquity to Al Qaeda-Gerard Chailand,Arnaud Blin (2007,

¹⁹ Lufta Psikologjike-Nevzat Tarhan

Tek truri i njeriut kjo gjë nuk është e mundur, sepse thjesht mënyra se si njeriu është i ndërtuar nuk lejon ndryshim në mënyrë drastike dhe gjithçka të vazhdojë të funksionojë për mrekulli.

Prandaj, në këtë aspekt, truri i njeriut funksionon pak më ndryshe. Për të shkruar diçka të re në trurin e njeriut duhet një procedurë e cila kërkon kohë, njësoj si kur mësohet diçka e re për të cilën nuk kemi pasur njohuri më parë.

Merret si shembull vozitja e veturës me marsh manual. Jemi të gjithë dëshmitarë që kjo procedurë kërkon një kohë të konsiderueshme për ta përsosur. Kjo ndodh për shkak se në trurin e njeriut krijohet një rrugë e cila sa më shpesh provohet dhe testohet, aq më shumë ajo përmirësohet dhe mbushet,

I njëjti proces ndodh edhe tek indoktrinimi dhe manipulimi i grupeve ekstremiste.

Target i këtyre grupeve janë moshat e reja të cilat për arsye logjike dhe të kuptueshme janë shumë më të rrezikuara. Kjo procedurë fillon me përhapjen e informatës e cila ka përmbajtje urrejtjeje dhe fyese, e cila në vështrim të parë mund të duket jo shumë shqetësuese. Por është vazhdimësia e përhapjes së këtyre fjalimeve për një kohë të gjatë dhe kjo bëhet nga liderë të respektuar fetar.

Shpesh fjala e tyre merret si e vërteta e vetme dhe nuk kundërshtohet sepse thuhet nga udhëheqësi. Në shumicën e rasteve këto grupe vuajnë nga mungesa e shkollimit dhe janë analfabet, dhe kjo shpjegon se përse mesazhet e përcjella nga udhëheqësi nuk hasin në rezistencë, por vetëm në mirëkuptim dhe bindje të verbër.

PROCESI I REKRUTIMIT

Individët që bëhen terroristë shpesh janë të papunë, në aspektin social individë të tjetërsuar që janë larguar nga shoqëria. Ata me pak arsimim, si të rinjtë në getot algjeriane ose në Rripin e Gazës, mund të përpiqen për t'u bashkuar me një grup terrorist nga mërzia dhe dëshira për të pasur një aventurë të mbushur me aksion, në ndjekje të një kauze që ata e konsiderojnë të drejtë. Disa individë mund të motivohen kryesisht nga dëshira për t'i përdorur aftësitë e tyre të veçanta,

të tilla si prodhimi i bombave. Të rinjtë më të arsimuar mund të motivohen më shumë nga bindjet e vërteta politike ose fetare. Personi i cili bëhet terrorist në vendet perëndimore është përgjithësisht edhe intelektual edhe idealist. Zakonisht, këta të rinj të zhgënjyer, të dy të arsimuar ose të paarsimuar, përfshihen herë pas here në protesta dhe disidenca.²⁰

Një individ që largohet nga shoqëria mund të bëhet po aq mirë murg ose një vetmitar në vend të një terroristi. Që një individ të zgjedhë të bëhet një terrorist, ai ose ajo do të duhej të motivohej për ta bërë këtë. Duke e pasur motivimin e duhur megjithatë, motivimi i duhur nuk është ende i mjaftueshëm. Terroristi i mundshëm do të duhet të ketë mundësinë për t'u bashkuar me një grup terrorist. Dhe si shumica e punëkërkesve, ai ose ajo duhet të jetë i pranueshëm për grupin terrorist, i cili është një grup shumë ekskluziv. Kështu, rekrutët jo vetëm që do të kishin nevojë të kenë një personalitet që do t'i lejonte ata të përshtateshin në grup, por edhe disa aftësi që i nevojiten grupit, të tilla si njohuri për armët ose aftësitë e komunikimit?²¹

Psikologjia e rekrutimit dhe anëtarësimit dallon dhe ndryshon në varësi të llojit të grupit.

Personi që i bashkohet një grupi terrorist anarkist, marksist nuk mund të llogarisë në mbështetje sociale, ndërsa personat që anëtarësohen në grupet separatiste ETA, IRA do ta kishin mbështetjen e grupit të caktuar etnik duke e bërë si lëvizje më të fuqishme.

Psikologu Eric D. Shaw ofron një rast të fortë për atë që quhet "Modeli i Rrugës Personale", me të cilin terroristët hyjnë në profesionin e tyre të ri.

Modeli i rrugës personale sugjeron që terroristët vinin nga pjesë të përzgjedhura, në rrezik të popullsisë, të cilët kanë pësuar nga dëmtimet e hershme të vetëvlerësimit të tyre. Aktivitetet e tyre të mëvonshme politike mund të jenë në përputhje me filozofitë sociale liberale të familjeve të tyre, por shkojnë përtej perceptimit të tyre për kontradiktën në besimet e familjes së tyre dhe mungesën e veprimit social.²²

Nga i gjithë ky elaborim arrijmë të kuptojmë që bartësit kryesor të akteve terroriste shpesh janë persona të cilët kanë probleme të ndryshme, duke filluar nga niveli individual, familjar dhe duke

²⁰Brainwashing The Science of Thought Control by Kathleen Taylor (2004,faqe 16)

²¹ Who Becomes a Terrorist and Why,The Psychology and Sociology of Terroris-Rex A.Hudson(2002,faqe 42)

²² Who Becomes a Terrorist and Why,The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson

vazhduar me situatën ekonomike e cila mund të jetë një shtysë, probleme psikologjike të cilat ndikojnë në funksionimin e trurit dhe perceptimin e tij ndaj botës së jashtme. Me një fajlë gjithçka që na rrethon mund të ndikojë që një person të marrë një drejtim të caktuar.

Mos t'i harrojmë vrasësit serik të cilët vetëm pasi ishin studiuar ishte kuptuar që shumë faktorë kishin ndikuar që ata të kryenin një akt të tillë si vrasja.

SHPËRLARJA E TRURIT

Eliminimi sistematik dhe shpesh i dhunshëm nga mendja e një personi i ideve më të vendosura, veçanërisht atyre politike, në mënyrë që një grup tjetër idesh të mund të zërë vendin e tyre; ky proces konsiderohej si një lloj konvertimi shtrëngues i praktikuar nga disa shtete totalitare ndaj disidentëve politikë.-Përkufizimi i "shpërlarjes së trurit" në fjalorin anglisht të Oksfordit

Synimi është të ndryshojë rrënjësisht një mendje në mënyrë që pronari i saj të bëhet një kukull e gjallë - një robot njerëzor - pa qenë e dukshme mizoria nga jashtë.

Qëllimi është të krijohet një mekanizëm me mish e gjak, me besime të reja dhe procese të reja mendimi të futura në një trup të robëruar. Ajo çka arrin është kërkimi i një race skllëvërishtë që, ndryshe nga skllëvërit e kohëve të vjetra, mund t'i besohet se nuk do të revoltohet kurrë, se do të jetë gjithmonë e përshtatshme ndaj urdhrave, si një insekt ndaj instinkteve.²³

Vetë fjala, sipas Hunterit, është një përkthim i konceptit kinez të xi-nao ose hsi-nao. Ky termu përdor si një përkthim bisedor i szu-hsiang-kaitsao ('reformë e mendimit') termi zyrtar i komunistëve kinezë për procedurat e tyre. Megjithatë, koncepti i hsi-nao, 'larja e zemrës' ose 'pastrimi i mendjes' duke përdorur meditim, është shumë më i vjetër se komunizmi. Hunter pretendon se daton në kohën e Meng K'o (i njohur si Mencius në Perëndim), një mendimtar konfuçian i shekullit të katërt p.e.s.. Nëse po, është një shembull i hershëm i traditës së gjatë të zbatimit të metaforave të larjes dhe pastrimit të mendjeve, shpirtave ose shpirtave njerëzorë.

²³Brainwashing The Science of Thought Control by Kathleen Taylor (2004,faqe 16)

Larja e trurit është më ambicioze dhe më shtrënguese sesa bindja e thjeshtë, dhe ndryshe nga të afërmit më të vjetër si indoktrinimi, ai është bërë i lidhur ngushtë me teknologji moderne mekanike.

Mund të dallohen tre komponentë të tjerë të rëndësishëm të konceptit të larjes së trurit.

Dallimi njohës

E para është çuditshmëria e besimeve të reja në krahasim me të vjetrat. Imagjinoni një tifoz futbollit fanatik që pretendonte se i ishte shpërlarë truri duke besuar se kapiteni i ekipit të tij ishte në fakt futbollisti më i mirë në botë. Vlen gjithashtu të përmendet se besimet e fituara rishtazi të një viktime të larjes së trurit mund ose nuk mund të jenë besime 'të arsyeshme' për t'u mbajtur në mjedisin e tyre aktual.²⁴

Dhe kjo ka një shpjegim logjik se për çfarë arsye ndodh. Në jetën e përditshme kemi dëgjuar shpesh thënien e urtë se të njohësh një person duhesh të konsumosh një thes me krypë dhe kjo nënkupton që asnjëherë nuk mund ta njohësh një person vetëm me një rast apo për një kohë të caktuar dhe njësoj vlen edhe për fenomene dhe dukuri të ndryshme sepse nuk jemi në dijeni për të gjitha veqoritë dhe karakteristikat e vërteta, andaj është shumë më e lehtë që të marrim qendrim të gabuara krahas një personi ose një ngjarjeje, grupi apo fenomeni dhe veprimet tona mos t'i marrim me një vetëdije të plotë.

Afati kohor

Besimet dhe personalitetet ndryshojnë vazhdimisht ndërsa njerëzit rriten. Besimi im për ekzistencën e Santa Claus tani është diametralisht i kundërt me besimin që kisha kur isha i ri. A është larë truri nga bota e të rriturve? Jo. Unë thjesht u rrita, duke pranuar gradualisht gjatë

²⁴Brainwashing The Science of Thought Control by Kathleen Taylor (2004,faqe 16)

rrugës se nuk kishte asnjë person të tillë si Santa Claus. Por merrni parasysh besimin jashtëzakonisht të fortë të mikut tim Keith në krishterim. Nëse Keith do të zhdukej për një muaj dhe më pas do të rishfaqej një ateist i zjarrtë, do të dyshoja se dikush kishte ushtruar ndikim të padrejtë, ndërsa nëse nuk do ta kisha parë Keith për dhjetë vjet, do të kisha shumë më shumë gjasa t'ia atribuojë gabimin shkaqeve natyrore.²⁵

Mitet që shpërlarja e trurit është një proces i cili nuk kërkon kohë të gjatë dhe nevojiten vetëm teknikat e duhura siç janë torturat e ndryshme dhe përdorimi i medikamenteve të ndryshme sikur nëpër filma, ka ndikuar shumë në keqkuptimin e procesit të shpërlarjes së trurit.

Shpërlarja e trurit në thelb ka ngulitjen në tru të një ideje apo formë të mendimi tek një individ, dhe në një farë mënyre edhe mësimi i zakonshëm ka të njëjtin qëllim. Por normalisht që për të mësuar diçka të re është e pamundur që një gjë e tillë të ndodhë brenda natës. Nevojitet kohë dhe praktikë e vazhdueshme për të përvetësuar një gjë të re. Askush nuk është diplomuar brenda natës, apo të kryejë shkollën për pilot brenda 1 jave.

Njësoj edhe shpërlarja e trurit kërkon kohë që një botëkuptim që vetëm e kemi ta zëvendësojë me një qëndrim i cili mund të jetë më radikal apo edhe më liberal.

Mundësia e fundit

Së fundi, siç u përmend më herët, shpërlarja e trurit (kur nuk përdoret si një fyerje rastësore) është shpesh një 'koncept i mjetit të fundit', zakonisht përdoret vetëm kur asnjë shpjegim tjetër nuk është i dukshëm.²⁶

²⁵Brainwashing The Science of Thought Control by Kathleen Taylor (2004,faqe 16)

²⁶Brainwashing The Science of Thought Control by Kathleen Taylor (2004,faqe 16)



27

PROPAGANDA

Në librin Lufta Psikologjike e autorit Nevzat Tarhan shtjellohet një kapitull i veçantë vetëm për propagandën. Ai aty sqaron se çfarë është propaganda dhe dallon disa lloje të saj.

Ndarja e propagandës bëhet në bazë të burimit se a është i hapur apo i mbyllur.

Propaganda e Bardhë

Nga vetë emri pozitiv na tregon se është propaganda e hapur dhe burimi dëshiron që të bëhet i ditur, ajo është e qartë dhe transparente.

²⁷<https://cartoonmovement.com/cartoon/terrorism-brainwashing>

Materiali i propagandas së bardhë është lajmi. Ata përdorin material abuzimi dhe gabimet e palës tjetër, duke u munduar që t'i shfaqin dobësitë në strukturën e kundërshtarit.

Një shembull shumë i mirë se si propaganda e bardhë u përdor më së miri është Hitleri. Ai duke dashur që të tregojë ndikimin e keq që kishin pasur sanksionet e Evropës ndaj ekonomisë në Gjermani nxiti një urrejtje të popullit ndaj evropianëve. Për të shtuar intensitetin e zjarrit ai hidhte benzinë, me teorinë e tij se raca ariane ishte racë e pastër e cila duhej të ishte udhëheqëse dhe duke arsyetuar me teorinë e Darvinit se më i forti qeverisë. Kështu, ai arriti që të fitonte besimin e popullit.

Në rastin e terrorizmit aktual, personi i Hitlerit zëvendësohet nga Bin Ladeni. Në rastin e Al Qaedas i cili me fjalimet e tij publike dhe gjuhën që përdorte ndjellte dëshirën për luftë dhe sakrificim në emër të kauzës. Megjithatë kjo është vetëm njëra anë e medaljes, sepse ana tjetër është ajo e nëntokës dhe aty krijohet propaganda e vërtetë. Propagandues të tillë janë media, familja, shkolla, udhëheqësit fetarë, lokalë, të cilët ndonjëherë edhe pa dashje nxisin urrejtje.²⁸

Propaganda e Zezë

Për dallim nga propaganda e bardhë, ajo e zeza është më e fshehur. Burimi i informacionit ruhet dhe mundohet që përmes mashtrimit, intrigave, gënjeshtreve, shpifjeve, dëshmive të rreme dhe korrupsionit të njollosë një person, grup apo shtet të caktuar. Siç u cek, privatësia është thelbësore.

Synimi i kësaj propagande është krijimi i një fryme depresive, dyshuese, negative.

Kjo formë është karakteristike e kohës kur jetojmë sepse teknologjia ka mundësuar një privatesi të tillë, që është shfrytëzuar maksimalisht nga grupet terroriste.

Mundësitë e propagandës së zezë janë:

²⁸ Lufta Psikologjike, Nevzat Tarhan-2018, faqe 43-44

Për shkak të natyrës sekrete, kundërpropaganda është më pak efektive.

Ata përgatisin terrenin për okupim, sepse veprojnë nga jashtë vendit të cilin dëshirojnë ta sulmojnë. Duke ngritur emocionin e frikës, thyen fuqinë e rezistencës.

Ata krijojnë dyshime të paqena se brenda kundërshtarëve ka tradhëtarë.²⁹

Propaganda Gri

Kjo lloj propagande është ndër armët më të fuqishme të luftës psikologjike. Te ky lloj i propagandës burimi nuk është i sigurt, autenticiteti i saj nuk mund të vërtetohet. Meqë krijuesit e propagandës janë të padefinuar, temat emocionuese mund të përdoren.

Qëllimi i propagandaës gri mund të jetë për të treguar diçka të plotë dhe të mjaftueshme që është realisht me të meta, e pa definuar dhe e paqartë ose që ka për qëllim ta paraqesë si të dyshimtë dhe ta zvogëlojë vlerën e diçkaje.³⁰

1.2 LUFTA KUNDËR SULMEVE TERRORISTE NË PERIUDHA TË NDRYSHME

Kapitulli do të hapet me një thënie:

“Terroristët duan shumë njerëz që shikojnë, jo shumë njerëz të vdekur”, Brian Jenkins

Kjo thënie është shkruar në vitin e largët 1975, çka dëshmon që studiuesit e vërtetë të studimeve të sigurisë kanë qenë në dijeni se problemi i terrorizmit ka qenë prezent edhe shumë kohë para 9/11.

Një prej formave më të sofistikuar të luftës kundër terrorizmit është rrjeti i përgjimit Echelon. Edhe ky rrjet është temë debati sot e kësaj dite rreth mosfunksionimit adekuat ditën e 11 shtatorit 2001.

²⁹ Lufta Psikologjike, Nevzat Tarhan 2018, faqe 48-52

³⁰ Lufta Psikologjike, Nevzat Tarhan-2018, Faqe 45-47

Zyrtarisht, Echelon nuk ekziston. Megjithëse provat e Echelon janë rritur që nga mesi i viteve 1990, Amerika e mohon kategorikisht se ekziston, ndërsa përgjigjet e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ndaj pyetjeve në lidhje me sistemin janë evazive.

SHBA, Britania e Madhe, Kanadaja, Australia dhe Zelanda e Re krijuan Echelon si pjesë e një klubi anglo-sakson, të krijuar me traktat sekret në vitin 1947. Pesë vendet ndan botën për të ndarë produktin e përgjimit global. Gjatë Luftës së Ftohtë, vëmendja e Echelon u përqendrua në komunikimet ushtarake dhe diplomatike'. Por kompjuterët gjithnjë e më të sofistikuar nënkuptojnë se Echelon mund të monitorojë objektivat industriale dhe individët privat.

Operacioni Echelon është i bazuar në Fort Meade në Maryland, Amerikë dhe në GCHQ në Cheltenham. Agjencitë nga të pesë vendet shkëmbejnë transmetime të përgjuara, duke përdorur superkompjuterë për të shënuar çdo mesazh që përmban fjalë kyçe të renditura në të ashtuquajturit 'fjalë të Echelon'. Këto transmetime regjistrohen dhe transkriptohen për analiza të ardhshme.³¹

Në një raport të bërë nga parlamenti evropian është vërtetuar prezenca e një programi të tillë.

Nuk është vetëm industria që është në rrezik. Raporti thotë se në procesin e spiunimit industrial, Echelon po përgjon miliona komunikime të përditshme mes njerëzve të zakonshëm.

Siç shpjegon eksperti i Agjencisë Kombëtare të Sigurisë, James Bamford në librin e tij *Body of Secrets*: "Çështja e vërtetë është nëse Echelon po heq privatësinë individuale, një e drejtë themelore e njeriut."³²

U sqarua se ky sistem funksionon në bazë të një fjalori i cili përgjon çdo person që përdor në internet fjalë kyçe të cilat janë të regjistruara në fjalor. U përmend që ky program kishte për qëllim spiunimin e kundërshtarëve të nivelit shtetëror, por më vonë rëndësia e tij u kuptua dhe filloi të përdoret si jashtë edhe brenda vetë shteteve që e kishin në përdorim.

Përpara se qeveria të shikonte përmes kamerave tona të internetit të gjurmonte hapat tanë përmes GPS-it, të ndiente çdo goditje të tastierës që shtypnim dhe të dëgjonte e të shikonte

³¹<https://www.theguardian.com/world/2001/may/29/qanda.janeperrone>

³²<https://www.theguardian.com/world/2001/may/29/qanda.janeperrone>

ndërsa krijonim grupe të dhënash komplekse të të gjithë personalitetit tonë në internet, kishte ende të dhëna rudimentare për t'u mbledhur. Gjatë pesëdhjetë viteve të fundit, Projekti ECHELON i ka dhënë MB-së dhe Shteteve të Bashkuara (si dhe anëtarëve të tjerë të Five Eyes) kapacitetin për të gjurmuar armiqtë dhe aleatët brenda dhe jashtë shteteve të tyre. Shtrirja ka evoluar në atë periudhë kohore nga ngritjet e fjalëve kyçe në fakset e përgjuara deri te mbledhja aktuale e të dhënave gjithëpërfshirëse.

Programi thuhet se përdori antena masive radio me bazë tokësore për të përgjuar transmetimet satelitore që përmbajnë komunikime dixhitale të miliona njerëzve. Më pas, ai u mbështet në fjalorët e tij të ndjeshëm ndaj përmbajtjes të fjalëve kyçe dhe frazave për të pastruar komunikimet për informacion përkatës.³³

Ky ishte niveli më i lartë i luftës kundër terrorizmit që kemi njohur në historinë njerëzore.

Tash kemi organizata specifike të cilat janë eksperte në fushën e terrorizmit dhe luftës kundër saj, edhe pse disa shtete të vogla siç janë ato të ballkanit, koordinojnë disa institucione, siç janë shërbimet inteligjente, policia, doganat ndërsa në disa shtete të fuqishme janë organizata të dedikuara vetëm për luftën kundër terrorizmit.

1.3 PERIUDHA E ARTË E TERRORIZMIT

Me të drejtë thuhet se 9/11 është epoka e artë e terrorizmit dhe arsytet janë më se të dukshme dhe të kuptueshme.

Ishte vetë sulmi me caqet e sulmuara dhe vendin që u sulmua pika kulminante arsyeja që kjo datë do të merret si epoka e artë e terrorizmit. Shteti më i fuqishëm në botë gjunjëzohet përballë disa individëve. Një precedent i tillë nuk kishte ndodhur më parë.

³³https://techcrunch.com/2015/08/03/uncovering-echelon-the-top-secret-nsa-program-that-has-been-watching-you-your-entire-life/?guccounter=1&guce_referrer=aHR0cHM6Ly93d3cuZ29vZ2xlLmNvbS8&guce_referrer_sig=AQAAAJ-g0tY0mn5GL2SwrR9Yrn-CpdTfJ0lqGRV9k12twP8ArXv-7pm4Fro-JB8ij5XU1zt54CDemPnsrDipOyZSFN66ZohdhUTMGUMmiKwx6HqsjkePsQt_bjfvGm5ZMD0MOjvpaCmA3fBQ7wGgf vAORUKEHJAfLe3XJgG5a-qgQAe

Në vazhdim do të sqarohet se përse sulmet e 11 shtatorit 2001 ishin ato që ishin.

-Politika

-Ekonomia

-Inteligjenca

Këto tre kategori janë edhe shtyllat e shtetit, çka nënkupton që janë vetë shteti.³⁴

Do të fillojmë me ekonominë për shkak se të gjithë jemi të familjarizuar me Kullat Binjake, simbol i sulmeve të 11 shtatorit, por në të njëjtën kohë edhe simbol i ekonomisë jo vetëm amerikane, por edhe asaj botërore.

Duke qenë jo vetëm qendra e ekonomisë amerikane, por edhe asaj botërore, impakti ishte shumë më i madh se çdo skenar normal. Gjithë bota kishte deleguar dhe besuar në qeverinë amerikane ekonominë globale, prandaj mosarritja e sigurimit ishte një katastrofë e dyfishtë si në nivel shtetëror, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Kjo shtyllë është zemra që pompon gjakun në të gjitha venat e shtetit. Kjo siguron që të gjitha dikasteret dhe fushat e jetës të jenë në gjendje të funksionojnë. Për ta ilustruar më thjeshtë, nëse në një pjesë të trupit të njeriut nuk qarkullon gjak, ajo pjesë fillon të vdesë dhe shkakton që edhe shumë pjesë tjera të keqfunksionojnë.

Njësoj edhe në rastin e 11 shtatorit, gjaku është paraja.

Superfuqia e një shteti vlerësohet kryekëput vetëm nga pasuria që ai ka. Mjafton vetëm të analizoni ndikimin që kanë shtetet e varfëra të Afrikës në OKB në krahasim me SHBA-NË, RUSINË, KINËN.

Pika e dytë e cila u sulmua në sulmin e 11 shtatorit ishte Pentagoni.

Pentagoni është ndërtesa zyrtare e departamentit të Mbrojtjes, e njohur më mirë si qendra e inteligjencës ushtarake amerikane, detyrë e së cilës është pikërisht parandalimi i ngjarjeve të tilla si sulmet e 11 shtatorit.

³⁴<https://www.history.com/topics/21st-century/9-11-attacks>

Të arrish të godasësh një pikë kaq nevralgjike me sukses kirurgjikal pa dyshim që meriton një vend të veçantë në piedestalin e sulmeve terroriste.

Dhe pika e fundit është ajo politike.

Ka ende shumë debate se a kishin cak Senatin Amerikan apo Shtepinë e Bardhë. Por cilado qoftë ajo nuk ka rëndësi shumë, sepse të dyja janë qendra ose simboli i politikës amerikane dhe nëse edhe ky qëllim do ishte përmbushur me sukses, atëherë me të drejtë do të ishte sulmi i përsosur terrorist.

Tre shtylla shtetngritëse dhe shtetmbajtëse të shkrumbuara në themel.

Por si duket perfeksionizmi nuk mund të arrihet, por përpjekjet për ta arritur shihet që nuk kanë munguar.


Ishte ngjarja e 11 shtatorit që shkaktoi një proces kataklizmik me vendime që ndryshuan edhe politikën globale dhe për herë të parë u nda në mes edhe blloku evropian sepse disa shtete nuk përkrahën qasjen që vendosi Amerika për të luftuar terrorizmin dhe shumë vite më vonë këto parashikime rezultuan të sakta sepse u vërtetua që lufta ishte një vendim i gabuar thuajse njësoj sikur edhe lufta në Vietnam, po nga Amerika. Siç duket SHBA-të kanë një histori të proceseve vendimarrëse që me kohë provojnë që janë vendime katastrofale.

Operacione të ndryshme që pasi u bënë publike shkaktuan një indinjatë globale ndaj praktikave amerikane që ishin aq jo efikase dhe brutale edhe kundër çdo ligji, konvente dhe rregulloreje ndërkombëtare, duke bërë lojëra fjalësh dhe duke i bërë lak disa mangësive juridike.

Operacionet e CIA në burgjet e tyre në vendet jashtë territorit amerikan dhe format e torturës ndër më barbare duke e ditur që jetojmë në shekullin XXI nuk mund të arsyetohen me asnjë mënyrë edhe pse përipiqen ta arsyetojnë me frazën,:"Qëllimi arsyeton mjetin"

Ata demonstrojnë se si, më shumë se një dekadë pasi administrata e Obamës e nxori të jashtëligjshëm programin – dhe më pas vazhduan të deklasifikonin pjesërisht një studim të Senatit që zbuloi C.I.A. gënjeu si për efektivitetin ashtu edhe për brutalitetin e tij - kapitulli i fundit i faqeve të zeza nuk është shkruar ende.

Z. Zubaydah, 48 vjeç, i vizatoi ato këtë vit në Guantanamo për t'i përfshirë në një raport prej 61 faqesh, "Si torturon Amerika", nga avokati i tij, Mark P. Denbeaux, një profesor në Shkollën Juridike të Universitetit Seton Hall në Newark, dhe disa nga studentët e zotit Denbeaux.³⁵




³⁶ FOTO-Gazeta New York Times

Por ato nuk arsyetohen në asnjë mënyrë sepse nuk është provuar që një sulm terrorist ka arritur të parandalohet me këto metoda.

³⁵<https://www.nytimes.com/2019/12/04/us/politics/cia-torture-drawings.html>

³⁶<https://www.nytimes.com/2019/12/04/us/politics/cia-torture-drawings.html>



³⁷FOTO – Gazeta New York Times

Ndërsa nëse flitet për përgjimin masiv me anë të teknologjisë, ajo është një temë tjetër e cila mund të arsyetohet nëse ajo vepron konform rregullave dhe ligjeve, duke mos dëmtuar persona që nuk kanë lidhje me terrorizëm, por edhe kjo mbetet një pikëpyetje sepse programi echelon dhe percjellësi i tij edhe pse mohet nga qeveritë, nuk kanë bërë dallim.

³⁷<https://www.nytimes.com/2019/12/04/us/politics/cia-torture-drawings.html>

1.4 HARTIMI I PLANEVE DHE STRATEGJIVE SHTETËRORE

SHBA

Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit të Brendshëm

Sipas ligjit federal, "terrorizmi në familje" përkufizohet si "aktivitete që përfshijnë akte të rrezikshme për jetën e njerëzve që janë shkelje e ligjeve penale të Shteteve të Bashkuara ose të çdo shteti; duket se synojnë të frikësojnë ose të detyrojnë një popullsi civile, të ndikojnë në politikën e një qeverie me anë të frikësimit ose detyrimit, ose të ndikojnë në sjelljen e një qeverie me shkatërrim masiv, vrasje ose rrëmbim; dhe ndodhin kryesisht brenda juridiksionit territorial të Shteteve të Bashkuara.³⁸

Shtete si SHBA kanë ligje dhe rregullore të ndryshme të cilat rregullojnë fushëveprimin dhe specifikojnë se cilat verpime mund të konsiderohen si akte terroriste dhe ndër më të rëndësishmet ajo i ndan detyrat edhe tek institucionet, për dallim nga vendet si Kosova që nuk ka një organizatë të vecantë që merret vetëm me terrorizëm.

SHBA ka edhe shërbime inteligjente të cilat janë të specializuara në luftën kundër terrorizmit mbi të cilat qëndron një organ i përgjithshëm i njohur si NSA (Agjencia Kombetare e Sigurisë) e cila është nëna e të gjitha shërbimeve inteligjente.

³⁸<https://www.whitehouse.gov/briefing-room/statements-releases/2021/06/15/fact-sheet-national-strategy-for-counteracting-domestic-terrorism/>

BRITANIA E MADHE

Strategjia e Mbretërisë së Bashkuar Kundër Terrorizmit

Përgjigja jonë ndaj kundër-terrorizmit është e ndërtuar mbi një qasje që bashkon sektorët publikë dhe privatë, komunitetet, qytetarët dhe partnerët jashtë shtetit rreth një qëllimi të vetëm për të mos lënë hapësirë të sigurt për terroristët për të rekrutuar apo vepruar. Strategjia jonë, CONTEST, është korniza që na mundëson të organizojmë këtë punë për të luftuar të gjitha format e terrorizmit. Qëllimi kryesor i CONTEST mbetet të zvogëlojë rrezikun për MB-në dhe qytetarët dhe interesat e saj jashtë shtetit nga terrorizmi, në mënyrë që njerëzit tanë të mund të vazhdojnë jetën e tyre lirisht dhe me besim.³⁹

Interesante tek strategjia e Britanisë së Madhe është inkorporimi i popullatës, siç u cek më lartë, sektori publik dhe privat, komuniteti dhe qytetarët.

Kjo ndihmon dhe lehtëson në masë të madhe identifikimin e hershëm të çdo precedenti që mund të jetë i rrezikshëm.

Nuk ka një bekim më të madh për institucionet e sigurisë se bashkëpunimi dhe mirëkuptimi me popullin sepse nga ai shpesh vijnë edhe informatat më të vlefshme.

E për të arritur një nivel kaq të mirë bashkëpunimi, institucionet e sigurisë duhet të punojnë fortë që të krijojnë këtë frymë besimi dhe sigurie në komunitet. Dhe kjo kërkon një kulturë të gjatë mirëfunksionimi të institucioneve.

³⁹https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/716907/140618_CCS207_CCS0218929798-1_CONTEST_3.0_WEB.pdf

KOSOVA

STRATEGJIA SHETËRORE KUNDËR TERRORIZMIT DHE PLANI I VEPRIMIT 2018 – 2023

Terrorizmi vazhdon të mbetet një nga kërcënimet kryesore të sigurisë vendore dhe globale duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe vetë mënyrën e jetesës së shoqërisë. Reagimi efikas ndaj terrorizmit kërkon përfshirjen dhe bashkëpunimin e të gjitha institucioneve publike, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, por edhe qytetarëve.

Ky dokument strategjik ka për synim kundërshtimin dhe luftimin e ideologjive ekstremiste apo radikale, të çfarëdo natyre qofshin ato, të cilat mund të shpijnë në përdorimin e dhunës dhe bien ndesh me normat dhe parimet demokratike të shoqërisë kosovare. Tutje, ajo synon parandalimin e aktiviteteve terroriste, minimizimin e rrezikut nga kërcënimet terroriste, si dhe uljen e cenueshmerisë përmes qasjes gjithëpërfshirëse, jo vetëm ndërinstitucionale, por gjithë shoqërore, e cila do të krijojë një bazë fleksibile për reagim më efikas ndaj kërcënimeve ekzistuese dhe dinamikave tjera gjithnjë në rritje dhe shumë dimensionale.⁴⁰

⁴⁰<https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/46/STRATEGJIA%20SHTET%3%8BRORE%20KUND%3%8BR%20TERRORIZMIT%20DHE%20PLANI%20I%20VEPRIMIT%202018%20E2%80%93%202023.pdf>

1.5 PËRKUFIZIMI I TERRORIZMIT SIPAS LEGJISLACIONIT NDËRKOMBËTAR DHE SHTETËROR

Një panel i OKB-së, më 17 mars 2005, e përshkroi terrorizmin si çdo akt "që synon të shkaktojë vdekje ose dëmtim të rëndë trupor për civilët ose joluftëtarët me qëllim të frikësimit të një popullsie ose detyrimit të një qeverie ose një organizate ndërkombëtare që të bëjë ose të abstenojë duke bërë çdo veprim.

Veprat kriminale të destinuara ose të llogaritura për të provokuar një gjendje terrori në publikun e gjerë, një grup personash ose personash të caktuar për qëllime politike janë në çdo rrethanë të pajustificueshme, pavarësisht nga konsideratat e një politike, filozofike, ideologjike, racore, etnike, fetare apo ndonjë natyrë tjetër që mund të përdoret për t'i justifikuar ato.⁴¹

Komiteti Ad Hoc për Terrorizmin në periudhën e pas Luftës së Ftohtë

Çdo person kryen një vepër penale sipas kuptimit të kësaj Konvente, nëse ai person, me çdo mjet, në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme, shkakton:

(a) Vdekja ose lëndimi i rëndë trupor i çdo personi; ose

(b) Dëme serioze në pronën publike ose private, duke përfshirë një vend të përdorimit publik, një shtet ose objekt qeveritar, një sistem transporti publik, një objekt infrastrukture ose për te mjedisi; ose

(c) Dëmtimi i pronës, vendeve, objekteve ose sistemeve të përmendura në paragrafin 1 (b) të këtij neni, që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike; kur qëllimi i sjelljes, për nga natyra ose konteksti i saj, është të frikësojë një popullatë, ose të detyrojë një qeveri ose një organizatë ndërkombëtare të bëjë ose të përmbahet nga kjo çdo akt.⁴²

⁴¹<https://dema.az.gov/sites/default/files/Publications/AR-Terrorism%20Definitions-BORUNDA.pdf>

⁴² The Routledge Handbook of Terrorism Research by Alex P.Schmid (2011,faqe 51)

KAPITULLI II

2.KONTEKSTI PSIKOLOGJIK

Kemi arritur në atë pikë që përgjigjen e çdo pyetjeje e drejtojmë nga aspekti psikologjik sepse kemi kuptuar që aty mund të gjendet çelësi i problemit dhe zgjidhja e tij.

Nuk ka qenë gjithmonë njësoj sepse shkolla tradicionale e të menduarit dhe këtë e themi jo vetëm për fushën e kriminalitetit por në përgjithësi, nuk ka kuptuar trurin dhe funksionin e trurit siç e kuptojmë sot, prandaj edhe botëkuptimi ka qenë më i thukët dhe i mangët.

Do të nevojitej iniciativa e dy personave që kanë gdhendur emrat e tyre në librat e historisë së psikologjisë kriminale e ata janë John E.Douglas dhe Mark Olshaker.

Të lidhur me dashurinë dhe përkushtimin e tyre për punën, ata fillojnë të shtrojnë rrugën për atë që sot njihet njësia e Shkencës së sjelljes.

Këta dy agjent morën në pyetje vrasës serik të ndryshëm dhe analizuan situatat e të gjithëve duke u munduar që të gjejnë disa elemente që ishin prezent tek të gjithë, çka automatikisht nënkuptonte që arrinin të deshifronin sjelljen e këtyre personave duke zbuluar arsyen e vërtetë se përse këta persona kishin kryer krime të tilla aq brutale, por në anën tjetër arritën që të krijojnë një model të disa shenjave paralajmëruese që kanë personat me tendencë kriminale që në moshë të re.⁴³

Por kjo nuk nënkupton që askush më herët nuk është marrë me studimin dhe analizimin e sjelljeve të njeriut dhe ndërlidhjen e tij me funksionin e trurit sepse kemi psikologë të famshëm, teoritë e të cilëve i mësojmë edhe sot e kësaj dite, siç është Sigmund Frojd dhe teoria e psikoanalizës.

⁴³ Mindhunter: Inside The FBI's Elite Serial Crime Unit-2017

Me ndihmën e teknologjisë është arritur që të kemi grafi të ndryshme në kohë reale, çka na e ka lehtësuar punën edhe më shumë.

2.1 HYRJE NË PSIKOLOGJINË FORENZIKE

Psikologjia mjekoligjore është një fushë që ndërthur praktikën e psikologjisë dhe ligjin.

Ndërsa psikologjia mjekoligjore konsiderohet një fushë specialiteti mjaft e re brenda psikologjisë, fusha daton në ditët më të hershme në historinë e psikologjisë. Filozofët dhe shkencëtarët kanë kërkuar prej kohësh të kuptojnë se çfarë i bën njerëzit të kryejnë krime, të sillen në mënyrë agresive ose të përfshihen në sjellje antisociale.

Sot, psikologët mjeko-ligjorë janë të interesuar jo vetëm të kuptojnë pse ndodhin sjellje të tilla, por edhe të ndihmojnë në minimizimin dhe parandalimin e veprimeve të tilla.⁴⁴

Shumë psikopatologji rezultojnë në shfaqjen domethënëse të sjelljeve antisociale. Disa nga këto janë antisociale në kontekstin e tërheqjes së të sëmurit, ndërveprimi social dhe izolimi i vetvetes si një mekanizëm mbrojtës për të ndihmuar shmangin mendimet, ndjenjat, sjelljet dhe reaksionet fiziologjike të pakëndshme që janë një tipar i çrregullimit.

Në përgjithësi, sjellja shmangëse e kësaj natyre nuk ka gjasa të rezultojë në sjellje kriminale. Përjashtim është rasti kur vetë-mjekimi me alkool ndërmerret nga një i mitur ose nëse një i rritur shkëmben alkoolin me substanca të paligjshme. Në raste të tjera, psikopatologjia ndikon në shfaqjen e sjelljeve që janë më shprehëse në natyrë. Kjo është për të le të themi, këto sjellje janë të përqendruara nga jashtë te njerëzit, kafshët ose objektet e tjera. Kur kjo ndodh, sjellja domosdoshmërisht prek të tjerët, qoftë drejtpërdrejt, si p.sh rasti i një sulmi, ose indirekt, si p.sh. kur sjellja përfshin vjedhjen e pronës ose dëmtim. Në këtë kontekst psikopatologjia ka të ngjarë të rezultojë në kriminalitet sjelljet. Sjelljet shprehëse mund të jenë të vullnetshme, jo të vullnetshme ose të rastësishme.

-E vullnetshme: Një sjellje e vullnetshme është një veprim i qëllimshëm që angazhohet për të arritur një fund specifik. Fundi mund të jetë ose jo një përpjekje legjitime. Një përpjekje legjitime

⁴⁴<https://www.verywellmind.com/an-overview-of-forensic-psychology-2794901>

mund të përfshijë akte të tilla si sulme seksuale ose fizike, vjedhje ose të tjera sjellje që ndërmerret si mjet i drejtpërdrejtë për të arritur një rezultat të dëshiruar.

-Jo-vullnetare: Një sjellje jovullnetare është një veprim i kryer si rezultat i njohjes delirante ose halucinogjene që krijojnë një supozim të rremë mbi pjesën e shkelësit. Halucinacione komanduese (p.sh., "Pulëbardha më tha ky njeri ishte i keq dhe ishte detyra ime ta godisja me thikë para se të lëndonte dikë tjetër") dhe mendimet delirante të shkakut dhe pasojës (p.sh., "nëse unë vras gruan e tij, atëherë ai do të më dashurojë mua dhe ne mund të jemi bashkë përgjithmonë") janë shembuj të kësaj forme vepre penale.

-Rastësore: Sjelljet e rastësishme janë veprime të paligjshme që ndodhin rastësisht me një tjetër objektiv. Një shembull i kësaj mund të jetë dikush që ka një patologji që paraqet si përgjithësisht shmangës, por e gjen veten në një situatë ankthi-provokuese që shkakton një sulm paniku. Si rezultat, individi mund të "sulmohet" në përpjekje për të shpëtuar (shmangur) stimujt që shkaktojnë frikë. Ai mund të sulmojë dikë, të shkatërrojë pronë ose vjedhë një biçikletë, makinë ose mjete të tjera transporti për të ikur.⁴⁵

-Pse disa individë vendosin të shkëputen nga shoqëria dhe të fillojnë një karrierë në terrorizëm?

- A ndajnë terroristët tipare apo karakteristika të përbashkëta? A ka një personalitet apo profil terrorist?

-A mund të zhvillohet një profil terrorist që mund të ndihmojë në mënyrë të besueshme personelin e sigurisë për të identifikuar terroristët e mundshëm, qofshin ata të mundshëm rrëmbyes aeroplanësh, vrasës apo kamikazë?⁴⁶

⁴⁵ The Psychology of Criminal Behaviour and Anti Social Behaviour.Victim and offender perspectives-Wayne Petherick & Grant Sinnamon 2017, faqe 21

⁴⁶ Who Becomes a Terrorist and Why,The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson 2018, faqe 24

2.2 ANALIZA E FAKTORËVE SOCIALË DHE PSIKOLOGJIKË

Të gjithë jemi pjesë e një lagjeje në të cilën jetojmë dhe bashkëveprojmë me persona tjerë duke filluar nga familja e deri tek rrethi shoqëror. Ky rreth shoqëror ka ndikimin e tij në mënyrën tonë të jetesës dhe mënyrën se si veprojmë.

Kemi raste të shumta kur dëgjojmë që një lagje e caktuar është e rrezikshme ose lagjia tjetër është shembull dhe të gjithë banorët janë njerëz të qetë.

Të gjitha këto kanë një bazë e cila është e vërtetë, por e cila nuk është absolute. Pra, edhe këtu mund të ketë përjashtime, por që janë në numër të vogël.

Sa i përket faktorit psikologjikë është pak më e komplikuar sepse ndikimi i të gjithë faktorëve krijon një model tek aspekti psikologjik, i cili na ndihmon të kuptojmë se përse një person ka kryer një akt të caktuar përmes pyetjeve të arta kriminalistike, të cilat janë të destinuara që të zbulojnë të fshehtën pas çdo krimi.

Qasja psikologjike ka të bëjë me studimin e terroristëve në vetvete, procesin e rekrutimit, futja në grupe terroriste, personalitetin e tyre bashkë me qëndrimet, motivet dhe karrierën si terroristë.⁴⁷

Terrorizmi zakonisht rezulton nga faktorë të shumtë shkakësor - jo vetëm psikologjikë por edhe ekonomikë, politikë, fetarë dhe ndër të tjera, sociologjikë. Terrorizmi është një dukuri shumëkauzale, do të ishte e thjeshtë dhe e gabuar të shpjegohej një akt terrorizmi nga një shkak i vetëm, siç është nevoja psikologjike e terroristit për të kryer një akt dhune.

Qasja fiziologjike ndaj terrorizmit sugjeron se roli i medias në promovimin e përhapjes së terrorizmit nuk mund të injorohet në asnjë diskutim lidhur me shkaqet e terrorizmit. Falë mbulimit mediatic, metodat, kërkesat dhe qëllimet e terroristëve u bëhen të njohura shpejt

⁴⁷ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson Faqe 35

terroristëve të mundshëm, të cilët mund të frymëzohen t'i imitojnë ata pasi të bëhen stimuluar nga rrëfimet mediatike për akte terroriste.⁴⁸

David G. Hubbard (1983) merr qasje fiziologjike për të analizuar shkaqet e terrorizmit. Ai diskuton tre substanca të prodhuara në trup nën stres: norepinefrinë, një përbërës i prodhuar nga gjëndra mbiveshkore dhe mbaresat nervore simpatike dhe të lidhura me "luftimin ose fluturimin" reagimi fiziologjik i individëve në situata stresuese; acetilkolina, e cila prodhohet nga mbaresat nervore parasimpatike dhe vepron për të zbutur përgjigjen e përsheptuar të norepinefrinës; dhe endorfina, të cilat zhvillohen në tru si përgjigje ndaj stresit dhe "narkotizon" trurin, duke qenë 100 herë më i fuqishëm se morfina.

Për shkak se këto substanca ndodhin te terroristi, Hubbard arrin në përfundimin se shumë dhunë terroriste nuk i ka rrënjët në psikologji, por në fiziologjinë e terroristit, pjesërisht rezultat i "indeve të stereotipizuara, të trazuara përgjigje" ndaj stresit. Përfundimi i Hubbard sugjeron një shpjegim të mundshëm për përhapjen e terrorizmit, të ashtuquajturin efekt ngjitës.⁴⁹

"Terroristët duhet, për nga natyra e veprimeve të tyre, të kenë një qëndrim që arsyeton dhunën".-Kent Layne Oots and Thomas C.Wiegle⁵⁰

Sipas Oots dhe Wiegele, një individ largohet nga të qenit terrorist potencial për të qenë një terrorist aktual përmes një procesi që është psikologjik, fiziologjik dhe politik. "Nëse modeli neurofiziologjik i agresionit është realist", pohojnë Oots dhe Wiegele, "nuk ka bazë për argumentin se terrorizmi mund të eliminohet nëse shkaqet sociopolitike u eliminuan." Ato karakterizojnë potencialin terrorist si "një individ i frustruar që është ngjallur dhe ka përjetuar në mënyrë të përsëritur sindromën e luftimit ose fluturimit. Për më tepër, pas këtyre ngjalljet e përsëritura, terroristi i mundshëm kërkon lehtësim nëpërmjet një akti agresiv dhe gjithashtu

⁴⁸ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson Faqe 34

⁴⁹ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson Faqe 34

⁵⁰ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson Faqe 34

kërkon, pjesërisht, të heqë shkakun fillestar të tij zhgënjimi nga arritja e qëllimit politik që ai ka qenë mohuar deri tani.”⁵¹

HIPOTEZA MBI FRUSTRIMIN-AGRESIONIN

Hipoteza frustrim-agresion e dhunës është e spikatur në letërsi. Kjo hipotezë bazohet kryesisht në hipotezën e privimit relativ, siç është propozuar nga Ted Robert Gurr (1970), një ekspert për sjelljet dhe lëvizjet e dhunshme, dhe riformuluar nga J.C. Davies (1973) për të përfshirë një hendek midis rritjes pritjet dhe nevoja për kënaqësi. Një tjetër përkrahës i kësaj hipoteze, Joseph Margolin argumenton se “sjellja e madhe terroriste është një përgjigje ndaj zhgënjimit të ndryshëm politik, ekonomik dhe nevojave e objektivave personale.”⁵²

Nuk është për tu befasuar që një numër shumë i madh i terroristëve vijnë nga vende që përballen me kriza të ndryshme të karakterit politik, ekonomik të cilat ndikojnë edhe në kualitetin e jetesës në nivel personal. Andaj duke qenë se ndjehen të pafuqishëm që me metoda paqësore të ndikojnë në përmirësimin e situatës, si rrugë të vetme e shohin dhunën me të gjitha format e saj. Shpesh këto akte të vogla dhunë, të cilat kanë karakter të izoluar, fillimisht kanë tendencën që shumë shpejt të eskalojnë dhe të marrin drejtim të gabuar, çka rrit shumë shanset për një luftë civile në atë vend.

Rast shumë i mirë për tu studiuar është sulmi mbi Capitol, me datë 6 janar 2020 e cila ndodhi pasi Joe Biden fitoj garën presidenciale, ndërsa sfidanti i tij Donald Trump kishte kohë që kishte paralajmëruar që në rast humbjeje, nuk do të pranonte humbjen.

Pas daljes së rezultateve, Donald Trump filloi kontestimin e tyre dhe atë në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë dhe për të mos mjaftuar me kaq, ai përdori rrjetet sociale për përhapjen e qëndrimit të tij se zgjedhjet ishin manipuluar dhe këto zgjedhje i janë vjedhur popullit amerikan.

⁵¹ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson Faqe 34

⁵² Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson Faqe 37-38

Duke ardhur këto fjalë nga një person i cili për 4 vite kishte qenë udhëheqës i një prej vendeve më të fuqishme linte pak vend për popullin e gjerë që të dyshonte në vërtetësinë e këtij informacioni edhe pse faktet flisnin për të kundërtën.

E gjithë kjo për mua është një akt terrorist i paramenduar dhe i planifikuar, i cili kishte për qëllim kontestimin dhe mospranimin e zgjedhjeve të drejta.

HIPOTEZA E IDENTITETIT NEGATIV

Duke përdorur teorinë e Erikson-it për formimin e identitetit, veçanërisht konceptin e tij për identitet negativ, psikologja e ndjerë politike Jeanne N. Knutson (1981) sugjeron që terroristi politik me vetëdije supozon një identitet negativ. Një nga shembujt e saj është një terrorist kroat i cili, si anëtar i një pakice etnike e shtypur, ishte e zhgënjyer nga dështimi i tij dhe aspiratat për të arritur një arsim universitar, dhe si rezultat ai përqafoi identitetin negativ duke u bërë terrorist. Identiteti negativ përfshin një refuzim hakmarrës të rolit të konsideruar si të dëshirueshëm dhe të duhur nga një familje dhe komunitetit të individit. Sipas Knutson, terroristët përfshihen në terrorizëm si rezultat i ndjenjave të tërbimit dhe pafuqisë mbi mungesën e alternativave.⁵³

ÇRREGULLIMET E PERSONALITETIT

Çrregullimet e personalitetit janë sindroma multifaktoriale që ndodhin përballë një ndërthurjeje të faktorëve biopsikosocial duke përfshirë trashëgiminë (gjenetikën dhe epi-gjenetikën), përvojat zhvillimore (abuzimi, trauma, shëndeti, atashimi, edukimi dhe ekspozimi mjedisor gjatë zhvillimit të trurit), të përgjithshëm sociale dhe karakteristikat mjedisore, dinamika personale anatomike

⁵³ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson, faqe 37-38

dhe fiziologjike, dhe cilësitë e lindura të karakterit. Sipas Petherick dhe Sinnamon simptomat e çrregullimeve të personalitetit përgjithësisht përfshijnë.⁵⁴

Çrregullim emocional, pamundësi për të mbajtur marrëdhënie pozitive, izolim social, shpërthime zemërimi, dyshime dhe mungesë besimi, pamundësi për të vonuar kënaqësinë, kontroll i dobët i impulseve dhe shpesh ka një histori abuzimi me alkoolin dhe/ose substancat. Mendimet dhe sjelljet e atyre me çrregullime të personalitetit konsiderohen në mënyrë karakteristike të çuditshme, melodramatike, tepër emocionale, të shqetësuara dhe/ose të frikshme. Shumë shenja dhe simptoma të çrregullimeve specifike të personalitetit "gjakderdhen" në njëra-tjetrën dhe shpesh është e vështirë të ofrohet një diagnozë e saktë që nuk mund të sigurohet ndryshe nga një mjek tjetër.⁵⁵

KARAKTERISTIKAT SOCIOLOGJIKE TË TERRORISTËVE GJATË LUFTËS SË FTOHTË

Profilet e terroristëve kanë përfshirë një profil të ndërtuar nga Charles A. Russell dhe Bowman H. Miller, i cili është përmendur gjerësisht në studimet e lidhura me terrorizmin, pavarësisht kufizimeve të tij, dhe një studim tjetër që përfshinte analizimin sistematik të të dhënave biografike dhe sociale për rreth 250 terroristë gjermanë dhe 350 të tjerë të etnive si argjentinase, brazilian, spanjoll, turk, palestinez që ishin aktivë gjatë periudhës 1966-76.

Ai e përmbledh kështu analizën e tij:

Deri në këtë pikë, ata kanë qenë kryesisht meshkuj beqar të moshës 22 deri në 24 vjeç, të cilët kanë një arsim universitar, ose diplomë kolegji. Terroristet femra, me përjashtim të Gjermanisë perëndimore grupe dhe një figurë e rastësishme udhëheqëse në JRA dhe PFLP, janë të preokupuar me role mbështetëse e jo operacionale. Pra, shumica e tyre u kthyen në terrorizëm

⁵⁴Motivations: Offender and Victim Perspectives-2013, faqe 21

⁵⁵ The Psychology of Criminal Behaviour and Anti Social Behaviour. Victim and offender perspectives-Wayne Petherick & Grant Sinnamon – 2017, faqe 26-29

si student universiteti ose më vonë, me botëkuptime anarkiste ose marksiste, si dhe u rekrutuan në operacione terroriste pikërisht gjatë kohës që ishin në universitet.

Interesant është fakti që një qasje e tillë përdoret edhe nga shërbimet sekrete të cilat rekrutojnë agjentët e tyre të ardhshëm shpeshherë nga kampuset e universitetve. Raste nga jeta reale kemi shumë dhe nuk do të shkojmë edhe aq larg.

Presidenti Rus Vladimir Putin pasi kishte kryer shërbimin e tij jashtë atdheut, në Gjermani, kthehet në Rusi dhe përkundër vështirësive, ai arrin që të punësohet në një Universitet dhe si detyrë kishte vëzhgimin e studentëve të huaj, por edhe rekrutimin e tyre apo edhe personave me potencial të cilët mund t'i hynin në punë shtetit rusë ose thënë më saktë shërbimeve sekrete të shtetit rus. Për më shumë mund t'i referohemi librit biografik "Putin's People How The KGB took back Russia and then took on the West" të shkruar nga Catherine Belton

Dhe ka një arsye se përse targetohen personat nëpër universitete.

Kjo periudhë e jetës është edhe periudha kur në shumicën e rasteve personat largohen nga familja së pari dhe janë larg tyre, kështu mungesa e kujdesit familjar ndikon edhe në mënyrën se si individ mendon dhe vepron. Një individ i ri i cili shijon lirinë nga familja dhe fillon që me mendjen e tij të marrë vendime nga më të thjeshtat deri tek ato më të komplikuarat. Tjetër faktor është edhe shoqërimi me persona të ri që nuk i ka njohur më parë dhe secili dallon nga tjetri në çdo aspekt.

Ky ndryshim kaq i madh në jetën e një personi kërkonë kohë deri sa të mësohet me një rutinë të tillë dhe njerëzit në këtë moshë priren të marrin vendime më impulsive dhe jo racionale andaj janë shumë më lehtë të manipulueshëm.

Rast konkret është Theodoro Kaczynski, i cili ishte manipuluar nga profesori i tij i cili gradualisht duke fituar besimin e tij, e fut Theodorin në një program special i cili menaxhohej nga shërbimet sekrete dhe kishte për qëllim thyerjen e mënyrës se si një person mendon dhe kjo me arsyen se Theodori kishte një mënyrë mendimi që dallonte nga shumica dhe konsiderohej i rrezikshëm. Kjo në fakt ishte edhe pika e kthesës për Tedin sepse deri në kolegji kishte qenë një person shumë i ndrojtur dhe me një rreth shoqëror shumë të ngushtë për të mos thënë fare dhe tek profesori në fjalë, pa shembullin të cilin ai gjithmonë kishte dashur për veten dhe për një kohë ishte i vetmi

person që mendonte që e kuptonte prandaj ai edhe u hap tërësisht me profesorin. Vlen të theksohet që Theodor Kaczynski kishte një nivel inteligjence mbi normalen që arrinte shifrën 167⁵⁶. Dhe të kujtojmë që Albert Einstein kishte nivelin 160.

Kjo na tregon që sa fragjilë jemi dhe sa lehtë mund të manipulohemi gjatë kohës që jemi në Universitet, sepse ende nuk kemi krijuar idetë dhe bindjet tona rreth botës dhe mënyrës se si funksionon. Jemi në procesin që pranojmë shumë informata dhe në shumicën e rasteve vetëm i marrim si të vërteta dhe nuk verifikojmë nëse ajo qëndron apo jo. As edhe një gjeni nuk mundi t'i bënte lak kësaj pune.

Mosha

Russell dhe Miller zbuluan se mosha mesatare e një terroristi aktiv (në krahasim me një udhëheqës) ishte midis 22 dhe 25, me përjashtim të terroristëve palestinezë, gjermanë dhe japonezë, të cilët ishin midis 20 dhe 25 vjeç. Një burim tjetër shpjegon se gjenerata e parë e RAF terroristët dolën në ilegalitet në moshën rreth 22 deri në 23 vjeç, dhe se mosha mesatare u zhvendos në 28 deri në 30 vjeç për brezin e dytë të terroristëve (Lëvizja e Dytë e Qershorit). Laqueur përmend se grupet arabe dhe iraniane priren të përdorin djemtë e moshës 14 deri në 15 vjeç për misione të rrezikshme, pjesërisht sepse ato kanë më pak gjasa të vihen në dyshim udhëzimet dhe pjesërisht sepse kanë më pak gjasa të tërheqin vëmendjen.⁵⁷

Statusi martesor

Gjendja martesore

Në të kaluarën, shumica e terroristëve kanë qenë të pamartuar. Russell dhe Miller zbuluan se sipas statistikave të arrestimeve, më shumë se 75 deri në 80 përqind e terroristëve në rajone të ndryshme në fund të viteve 1970 ishin beqarë. Përgjegjësitë e rënuara familjare përgjithësisht

⁵⁶<https://www.crimemuseum.org/crime-library/terrorism/ted-kaczynski-the-unabomber/>

⁵⁷ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson faqe 2018,69

përrjashtohen nga kërkesat për lëvizshmëri, fleksibilitet, iniciativë, siguri dhe përkushtim total ndaj një kauze revolucionare.

Afërsisht 20 për qind e anëtarësimeve të grupeve të huaja terroriste me sa duket përbëhej nga çifte të martuara.⁵⁸

Të jeshë terroristë është një punë me orar të plotë nëse mund të themi dhe në shumicën e rasteve është aq sekrete sa edhe puna tek një shërbim sekret, prandaj për një aktivitet të tillë nuk mund të flasësh me të tjerë sepse në rastin më të mirë personi i afërt me ty do të mundohet të ta kthejë mendjen, ndërsa në rastin më të keq mund të zbulohesh dhe të përfundosh pas grilave ose i vvarë.

Gjinia

Meshkujt

Shumica e terroristëve janë meshkuj. Mbi 80 për qind e operacioneve terroriste në periudhën 1966-1976 u drejtuan, drejtoheshin dhe ekzekutoheshin nga meshkuj. Këtë sugjeronte numri i femrave terroriste të arrestuara në Amerikën Latine ku anëtarësimi i femrave ishte më pak se 16 për qind. Roli i grave në grupet e Amerikës Latine si trupa te armatosura ishte i kufizuar në mbledhjen e inteligjencës, shërbimin si korriere ose infermiere, mirëmbajtjen e kasafortave, e kështu me radhë.⁵⁹

Femrat

Specialistë të ndryshëm të terrorizmit kanë vënë në dukje se numri i grave të përfshira në terrorizëm e ka tejkaluar shumë numrin e grave të përfshirë në krim. Megjithatë, asnjë statistikë e ofruar nuk e vërteton këtë pohim. Duke pasur parasysh se numri i akteve terroriste të kryera në mbarë botën në çdo vit të caktuar është ndoshta i vogël në krahasim me krimet e zakonshme të kryera në të njëjtën periudhë, nuk është e qartë nëse pohimi është i saktë. Megjithatë, me të

⁵⁸ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson faqe 2018, faqe 70

⁵⁹ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson, 2018, faqe 75-80

vërtetë duket sikur më shumë gra janë të përfshira në terrorizëm sesa në fakt, ndoshta sepse ato priren të marrin më shumë vëmendje sesa gratë e përfshira në krime të zakonshme.

Komandot famëkeqe femra kanë përfshirë Leila Khaled, një bukuroshe Komando i PFLP që rrëmbeu një aeroplan pasagjerësh TWA më 29 gusht, 1969, dhe më pas e hodhi në erë pas evakuimit të pasagjerëve, pa shkaktuar ndonjë viktimë.^{60\}

Femrat janë më të prirura që t'i shmangen akteve të drejtpërdrejta të dhunës dhe gjithmonë kërkojnë një rrugë e cila do të arrinte rezultatet e nejtës pa u detyruar përdorimi i forcës. Andaj kemi shumë pak raste të femrave të cilat kanë kryer sulme vetëvrasëse, por në anën tjetër numri i tyre rritet kur bëhet fjalë si udhëheqëse dhe hartuese të planeve.

Mendje e vetme

Terroristët femra mund të jenë shumë më të rrezikshme se terroristët meshkuj për shkak të aftësisë së tyre për t'u fokusuar me mendje të vetme në kauzën dhe qëllimin. Lochte vuri në dukje se rasti i Susanne Albrecht tregoi këtë përkushtim total ndaj një kauze, duke përjashtuar çdo gjë tjetër, madje edhe lidhjet familjare dhe edukimin.⁶¹

Nuk janë vetëm femrat shqetësim sepse një numër shumë të madh e përbëjnë edhe meshkujt. Duhet të jetë një shqetësim kryesor trajtimi dhe studimi i rasteve të tilla sepse në epokën e teknologjisë kjo kategori ka pësuar një rritje shumë të madhe si rrjedhojë e mundësisë se qasjes në internet dhe përhapjes së ideologjisë radikale shumë më shpejtë dhe në mënyrë efikase se kurrë më parë.

Ajo që e bënë vërtetë të frikshme këto formë është fshehtësia me të cilën organizohen dhe veprojnë, sepse shumë shpesh momenti kur kapen është shumë vonë. Dhe e gjithë kjo ka një arsye.

⁶⁰ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson, 2018, faqe 78

⁶¹ Who Becomes a Terrorist and Why, The Psychology and Sociology of Terrorism-Rex Hudson, 2018, faqe 80

Grupet tradicionale terroriste që jemi mësuar t'i kemi dalluar shumë që nga niveli më fillestar, që është numri i anëtarëve. Ky dallim rrënjësor ndikon edhe në të gjithë procesin përcjellës. Sepse një grup kërkon një organizim shumë më të detajuar duke pasur parasysh ndarjen e detyrave, menaxhimin e tyre, sigurimin e mbarëvajtjes, furnizimin e tyre me të mira materiale, caktimin e një vendtakimi dhe trajnimi.

Të gjitha këto rrisin nivelin e pikasjes dhe kapjes me arsyen e thjeshtë, një grup individësh bie në sy më lehtë se një individ i cili është i padiktueshëm kur ai përzihet me njerëzit e thjeshtë.

2.3 ANALIZA E FAKTORËVE EKONOMIKË DHE KULTURORË

Faktorët që përbëjnë një sistem të tillë referimi kombëtar janë të shumtë dhe të shumëllojshëm, mes tyre identiteti kombëtar, vetëpamja kombëtare dhe roli i perceptuar i shtetit në botë si dhe kultura politike. Por përfshihen edhe pikëpamjet e mbajtura për të tjerët, pasi pikëpamjet e vetvetes dhe pikëpamjet për të tjerët formohen në ndërveprim. Pjesë e kësaj kornize janë edhe mitet kombëtare dhe përvojat historike. Edhe interesat, për aq sa janë institucionalizuar politikisht, mund të jenë pjesë. Këta faktorë ndërveprojnë, duke qenë reciprokisht konstituues. Së bashku ato veprojnë si një kornizë në të cilën ndodhen proceset e perceptimit, interpretimi dhe krijimi i politikave (shihen sa) të jetë e mundur. Ato mundësojnë pikëpamje dhe veprime të caktuara, ndërkohë që kufizojnë, çaktivizojnë ose parandalojnë të tjerët. Në thelb, korniza kombëtare e referencës është baza psikologjike e një shteti.

Një kuadër kombëtar referimi mund të zgjerohet gjithashtu për të lejuar përfshirjen e pikëpamjeve të tjera ose të reja. Megjithatë, ndryshime të tilla ka të ngjarë të ndodhin në një afat më të gjatë. Që ndryshimi të ndodhë, nevojitet një lloj shtytje, ndoshta një krizë që detyron interpretime të reja mbi politikëbërësit ose presione të tjera të forta. Megjithatë, kryesisht,

sistemi kombëtar i referencës së një shteti do të ruajë elementet dhe argumentet e tij thelbësore, pasi këto ndërtohen mbi njëri-tjetrin dhe në këtë mënyrë konfirmohen vazhdimisht.⁶²

Terrorizmi ka një ndikim negativ në ekonomi, duke i bërë individët më të varfër. Prandaj, hulumtimi fokusohet në atë se si të matet një ndikim i tillë negativ dhe të vlerësohet madhësia e tij në dimensione të ndryshme. Megjithatë, lidhja shkakësore nga varfëria te terrorizmi nuk është aq e lehtë për t'u vendosur sa mund të sugjerojë intuïta. Kushtet ekonomike luajnë një rol në shpjegimin e rezultateve të terrorizmit, por efekti i tyre ndërmjetësohet nëpërmjet përcaktuesve të tjerë, duke e bërë lidhjen shkakësore nga varfëria te terrorizmi, nëse ekziston, shumë më komplekse. Ky artikull është i organizuar si më poshtë: Pas një seksioni që përmbledh pasqyrat e përgjithshme të fushës së studimeve të terrorizmit në përgjithësi dhe të ekonomisë politike të terrorizmit në veçanti, dy seksione organizojnë bibliografinë e komentuar në lidhje me fillimin e lidhjes shkakësore nga terrorizmi në varfëri dhe më pas nga varfëria ndaj terrorizmit. Pasojat e shumta ekonomike të terrorizmit janë referuar në nënseksione të ndryshme kushtuar kostos së përgjithshme ekonomike të terrorizmit dhe ndikimit të tij në investime, vlerësimin e tregut të firmave dhe sektorin e turizmit.⁶³

Dihet edhe është vërtetuar se gjendja ekonomike e rënduar ndikon edhe në rritjen e nivelit të kriminalitetit në forma të ndryshme. Dhe terrorizmi është një krim i cili sanksionohet me çdo ligj qoftë ai kombëtar ,ndërkombëtar dhe konventa të ndryshme. Si rrjedhojë, as terrorizmi nuk është imun ndaj këtij ndikimi.

Por ajo që e rëndon më shumë situatën është kur në ekuacion përfshihet edhe elementi kulturor i cili shpesh luan rolin e katalizatorit në ngritjen e pakënaqësive deri në atë nivel që eskalon në dhunë.

Shpesh kur kemi grupe të ndryshme etnike dhe religjioze, të cilat jetojnë në të njejtën zonë dhe kanë pretendime të njejtja për zonën në fjalë, mund të ndiejmë erën e tensionit në ajër, sepse kjo frymë tensioni ekziston në çdo cep.

⁶²<https://digitalcommons.usf.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1036&context=jss>

⁶³<https://www.oxfordbibliographies.com/view/document/obo-9780199743292/obo-9780199743292-0296.xml>

Rast të vërtetë mund të marrim konfliktin mes Pakistanit dhe Indisë i cili ka vite që vazhdon si me sulme të mirëfillta ushtarake, por edhe me sulme të shpeshta terroriste. Kur analizojmë situatën tek ky konflikt, kemi të gjitha atributet e mungesës së stabilitetit ekonomik dhe urrejtja etnike ndikojnë drejtpërdrejtë në numrin e akteve terroriste.

Nuk është vetëm ndikimi i një ekonomie të keqe dhe të ngecur e gjithë ana e historisë sepse edhe sulmet terroriste në anën tjetër kanë ndikim shumë të madh në ekonominë globale duke e ngadalësuar jo pak rritjen ekonomike.

Faktet që do të shfaqen në vijim do të tregojnë se sa i kushton botës terrorizmi çdo vit.

Kostoja e terrorizmit në botë ishte 52.9 miliardë dollarë në vitin 2014, më e larta që nga viti 2001, sipas Indeksit të ri Global të Terrorizmit 2015.⁶⁴

⁶⁴<https://www.visionofhumanity.org/wp-content/uploads/2021/01/EVP-2021-web-1.pdf>

FIGURE 34 THE COSTS OF TERRORISM, US\$ BILLIONS, 2000–2014

Based on IEP's methodology, the global economic costs of terrorism reached the highest ever level in 2015 at \$52.9 billion. Figures reported in constant 2014 US\$ billions.



Source: IEP Calculations

NOTE: Figures include property damage from the September 11 attacks.⁶⁵

65

FOTO: KOSTOJA EKONOMIKE E SULMEVE TERRORISTE

Faktorët ekonomiko-social nuk ndikojnë njësoj në të gjitha vendet dhe këto dallime vërehen më shumë tek vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim e sipër ose të varfëra dhe këtë e fakton edhe raporti nga Instituti për Ekonomi dhe Paqe, i cili çdo vit analizon dhe nxjerr përfundime rreth paqes dhe ngjarjeve të ndryshme siç është edhe terrorizmi dhe efekti që kanë ato në ekonomi.

- Nivelet e larta të ankesave të grupit dhe një sundim i dobët i ligjit është i ndërlidhur me terrorizmin në të gjitha vendet.
- Në vendet më të zhvilluara ekonomisht, heqja e të drejtës sociale dhe përjashtimi luajnë një rol të rëndësishëm në terrorizëm.

⁶⁵<https://www.visionofhumanity.org/wp-content/uploads/2021/01/EVP-2021-web-1.pdf>

- Në vendet më pak të zhvilluara ekonomikisht, përçarjet fetare ose etnike dhe korrupsioni janë të lidhura më fort me nivele të larta terrorizmi.⁶⁶

2.4 ANALIZË E SULMEVE TË NDRYSHME TERRORISTE NGA KONTEKSTI PSIKOLOGJIK

Dy elemente të përbashkëta zakonisht gjenden në përkufizimet bashkëkohore: (1) që terrorizmi përfshin agresion kundër joluftëtarëve dhe (2) që veprimi terrorist në vetvete nuk pritet nga autori i tij për të përmbushur një qëllim politik, por përkundrazi të ndikojë në një audiencë të synuar dhe të ndryshojë sjelljen e audiencës në një mënyrë që do t'i shërbejë interesave të terroristit.

Në bazë të intervistave të pastrukturuara, psikiatri amerikan David Hubbard (1971) raportoi pesë tipare të rrëmbyesve të aeroplanëve: (1) babai i dhunshëm, shpesh alkoolist; (2) nënë thellësisht fetare; (3) seksualisht i turpshëm, i ndrojtur dhe pasiv; (4) motrat më të vogla ndaj të cilave terroristi ka vepruar në mënyrë mbrojtëse; dhe (5) arritje të dobëta sociale.⁶⁷

Sprinzak dhe Denny kryen intervista gjysmë të strukturuara me tridhjetë e pesë ekstremistë të burgosur të Lindjes së Mesme, duke përfshirë njëzet e një terroristë fetarë islamikë nga Hamasi dhe krahu i tij i armatosur, Izz a-Din al-Qassam, Xihadi Islamik dhe Hezbollahu, si dhe katërmëdhjetë terroristë laikë nga Fatah. Shumica kishin arsim të mesëm; disa kishin shkollim shtesë. (Megjithatë, nëngrupi i sulmuesve vetëvrasës mes palestinezëve u përshkrua si mosha shtatëmbëdhjetë deri në njëzet e dy vjeç, "të pashkolluar, të papunë, të pamartuar.") Shumica vinin nga familje të respektuara që mbështetën aktivizmin e tyre, me 30 për qind të familjeve të terroristëve fetarë dhe 15 për qind e familjeve të terroristëve laikë raportojnë përfshirjen e tyre radikale. Ndikimi i bashkëmoshatarëve u përmend si arsyeja kryesore për t'u bashkuar me një grup terrorist dhe për t'iu bashkuar rritjes së statusit shoqëror. Anëtarësia u përshkrua si e lidhur me një shkrirje të identitetit individual të të rriturve të rinj me identitetin dhe qëllimet kolektive të grupit.

⁶⁶ GLOBAL TERRORISM INDEX 2020-The Institute for Economics and Peace

⁶⁷https://www.diplomatie.gouv.fr/IMG/pdf/critik_psychoterrorisme.pdf

Të dhëna potencialisht me vlerë të lartë u mblodhën jashtë aparatit kërkimor akademik nga punonjësja e ndihmës e Kombeve të Bashkuara (OKB), Nasra Hassan, bazuar në intervistat e pastrukturuara me "gati 250" anëtarë të Hamasit ose Xhihadit Islamik të kryera në Gaza midis 1996 dhe 1999. Ajo raporton se Kamikazët varionin nga mosha tetëmbëdhjetë deri në tridhjetë e tetë vjeç, më shumë se gjysma ishin refugjatë, "shumë" ishin të klasës së mesme, 2 ishin bij milionerësh dhe asnjë nuk ishte në depresion, megjithëse "shumë" raportuan se ishin rrahur ose torturuar nga forcat izraelite.⁶⁸

Shpesh rezultatet më të mira arrihen kur improvizojmë dhe nuk i përmbahemi rregullave strikte të cilat nuk janë të zbatueshme për çdo rast.

Ajo çfarë ky raport konfirmon është që mosha e terroristëve është relativisht e re dhe faktorët socio-ekonomik i ndezur edhe nga elementi fetar, është një përzierje shumë e rrezikshme me potencial për të krijuar një terrorist që më të vërtetë i duhet frikësuar.

⁶⁸https://www.diplomatie.gouv.fr/IMG/pdf/critik_psychoterrorisme.pdf

KAPITULLI III

3. RËNDËSIA PSIKOLOGJIKE E TERRORIZMIT

Nga shembujt e elaboruar deri më tani është krijuar një ide se sa e rëndësishme është psikologjia në kuptimin e krimit.

Në çdo fushë të jetës si në art, shkencë, kulturë dhe marketing është duke iu kushtuar rëndësi e veçantë qasjes psikologjike, sepse është kuptuar thelbi i problemit, që sukcesi fshihet në kuptimin e psikologjisë njerëzore sepse të gjitha këto shërbime dhe produkte kryhen nga njerëzit për njerëzit.

Nuk është arritur ende një nivel zhvillimi që të kemi kontakt me jashtëtokësorë dhe si rrjedhojë fokusi ynë duhet të jetë në zbërthimin dhe kuptimin e trurit të njeriut.

3.1 RËNDËSIA E PSIKOLOGJISË NË FUSHËN E KRIMIT

Tema e diskutimit për rëndësinë e psikologjisë në fushën e krimit është shtjelluar në mënyrë më thelbësore në kapitujt paraprak. Andaj krejt çka do të shtjellohet në këtë kapitull, është ilustrimi i disa shembujve konkret nga jeta reale se si psikologjia ka arritur të zbërthejë dhe të japë përgjigje për shumë krime, ndër më makabret.

“E kapa dhe fillova ta mbyjtja dhe e tërhoqa zvarrë nga shtrati, e hodha në cep të dhomës sime në dyshemenë e pllakave, nga qilimat. Ajo po përpiqej, ju e dini, të bërtiste dhe po luftonte. Por sigurisht që ajo me të vërtetë nuk mundi, pasi unë i kisha duart rreth fytit të saj. Uh . . . ajo ndaloi së luftuari. . . thjesht u shtri atje. U veshu. Kisha djersitur kaq shumë. Dola në garazh. Mora disa qese plastike për ta futur. Duke u kthyer nga garazhi, pashë që ajo ishte ende duke lëvizur, kështu që fillova ta mbyta përsëri dhe e godita kokën në dysheme në mënyrë të përsëritur. Asaj i filloi të

rrjedh gjak nga hunda, goja, fytyra. . . nuk e di ku. Kishte gjak në të gjithë dyshtemenë. Më pas mora një nga qeset plastike dhe ia vura mbi kokë, e përdredha fort dhe e mbajta aty derisa ajo ndaloi.”⁶⁹

Kur u kthye në Hillsdale, ai iu bashkua kërkimit të lagjes për Joan.

“U ndjeva më mirë kur u ktheva në shtëpi,” i tha ai Dr. Galen. “Kam fjetur mirë”⁷⁰

Ishin këto fjalët e thëna nga kriminelin Joseph McGowan në praninë e agjentëve special që ishin duke studiuar sjelljet e kriminelëve.

Edmund Emil Kemper III është një nga vrasësit serialë më famëkeq të Amerikës. I njohur si "The Co-Ed Killer" për shkak të predikimit të tij për vajzat e reja të bukura të kolegjit, ai preu autostopistë në Kaliforninë Veriore në fillim të viteve 1970, duke i vrarë dhe më pas duke i marrë trupat e tyre të pajetë në shtëpi, ku do të gjymtohej dhe do të bënte seks me to. Viktimat e tij të para ishin gjyshërit e tij nga babai, të cilët ai i vrau kur ishte 15 vjeç, dhe të fundit ishin nëna e tij dhe shoqja e saj më e mirë gjatë fundjavës së Pashkëve në 1973.

Brenda, Kemper ndau detaje grafike të vrasjeve të tij. Kur u pyet se çfarë mendoi kur pa "një vajzë të bukur që ecte në rrugë", ai u përgjigj në mënyrë të famshme.

Njëra anë e imja thotë: 'Uau, çfarë goce tërheqëse. Do të doja të flisja me të, të dilja me të.'
Ndersa ana tjetër e imja thotë: 'Pyet veten se si do të dukej koka e saj në një shkop?'⁷¹

Thuhet se veprimet tona tregojnë karakterin dhe personalitetin tonë, pra në një mënyrë janë një lloj i ADN-së i trurit tonë.

⁶⁹ The Killer Across the Table,Unlocking The Secrets of Serial Killers and Predators with the FBI’s real MindHunter-
John E. Douglas,Mark Olshaker

⁷⁰ The Killer Across the Table,Unlocking The Secrets of Serial Killers and Predators with the FBI’s real MindHunter-
John E. Douglas,Mark Olshaker

⁷¹<https://www.oxygen.com/kemper-on-kemper-inside-the-mind-of-a-serial-killer/crime-time/shocking-interviews-ed-kemper>

Shkenca ka arritur deri në atë pikë që të caktojë disa modele dhe shenja paralajmëruese që na lehtësojnë shumë punën në parandalimin e krimit sepse, një studiues i sigurisë duhet që gjithmonë ta ketë prioritet parandalimin e çdo krimi dhe jo ta zbulojë atë sepse pasi të kryhet krimi atëherë do të jetë shumë vonë.

Disa shenja paralajmëruese që çdo kriminalist duhet t'i dijë janë:

-Sjellja Antisociale

Në çdo rast që kemi të bëjmë me krime që janë të një niveli si vrasja duhet që të dihet se çfarë sjellje ka pasur personi në familje, lagje, shkollë dhe shoqëri. Shumë vrasës serik ishin të tërhequr dhe rrethi shoqëror ishte shumë i ngushtë, çka nënkupton mungesën e komunikimit dhe shprehjes, çdo problem e mbajnë brenda vetes dhe këto shpesh akumulohen për një kohë të gjatë deri sa shpërthejnë.

-Arsonizmi

Shumë vrasës serik fillojnë si zjarrvënës. Zjarrvënia është psikologjikisht tërheqëse sepse përfshin manipulimin e pushtetit dhe kontrollit, diçka që ofron edhe vrasja serike.

-Torturimi i kafshëve të vogla

Kjo është ndër shenjat kur duhet të ndizen sirenat automatikisht nga prindërit së pari, sepse çdo injorim vetëm e rëndon problemin. Dhe shpjegimi është logjik.

Një fëmijë nga mosha 4 deri 15 nuk e ka fuqinë që të vrasë ose lëndojë një person tjetër, prandaj ai mundohet që në mënyrë proporcionale me forcën e tij të gjejë viktimën e tij. Shpesh janë mace dhe zogj sepse edhe reagimi i tyre është më i vogël.

-Jeta e varfër familjare

Kushtet e vështira ekonomike dhe mungesa e të mirave materiale janë motiv që personat të sigurojnë të mirat me rrugë tjera. Dhe këtë mundësi për sukses të menjëhershëm ia ofron rruga kriminale.

-Keqtrajtimi në moshë të vogël

Abuzimi gjatë fëmijërisë shkakton dëme në zhvillimin e mirëfilltë të trurit tek njeriu sepse lë pasoja të përherëshme te njeriu. Një person që rritet në një ambient të dhunshëm mësohet që zgjidhja e çdo problemi të kryhet me anë të dhunës, në të njejtën kohë edhe besimi në njerëz zbehet tepër sepse familja konsiderohet si shtylla mbështetëse e një fëmije dhe në mometin kur ai fëmijë nuk mbështetet as tek familja, atëherë askush nuk mund t'i ndihmojë.⁷²

-Vojerizmi

Personat e tillë, siç u tha më lart, shpesh herë janë antisocial, prandaj ata zhvillojnë vojerizmin nga larg duke mos ndërvepruar me aktivitetet sociale. Ata i përkushtohen kësaj pune aq shumë sa që mund të kalojnë orë të tëra duke vështruar diçka ose edhe ndonjë viktimë.

-Inteligjenca

Një pikë tjetër interesante është edhe intelgjenca. Jemi mësuar me pikëpamjen se krime kryejnë vetëm personat me inteligjencë të ulët, por praktika ka vërtetuar të kundërtën. Shumë krime të tmerrshme kanë pasur një tru gjenial pas tyre. Niveli i inteligjencës te këta persona shpesh është mbi mesataren.

-Mosvendosmëria

Personat që kanë predispozita kriminale i dallon edhe një veçori që është mosvendosmëria.

⁷²<https://www.crimemuseum.org/2014/06/23/9-early-warning-signs-for-serial-killers-2>

Persona të tillë e kanë shumë të vështirë të mbajnë lidhje qofshin ato personale apo edhe profesionale.⁷³

3.2 RËNDËSIA E PSIKOLOGJISË NË SHFAQJEN DHE EKZEKUTIMIN E AKTEVE TË NDRYSHME TERRORISTE

Shkaqet pak a shumë dihen se pse një grup ose individ kryen një akt terrorist dhe tani do ta bëhet edhe dallimi në mes të një vrasësi psikopat serik dhe një vrasësi terrorist.

I pari kryen aktet e vrasjes për një periudhë të caktuar kohore dhe qëllimi i tij kryesor është të vazhdojë sa më tepër që është e mundur me aktet e tij, pa u kapur nga policia dhe kjo na tregon shumë për dallimin dhe mënyrën se si funksionon truri i një terroristi dhe vrasësi serik.

Nga ana tjetër, edhe terroristi kryen aktin e vrasjes, që në shumicën e rasteve është sulm vetvrasës dhe vë në shënjestër një grup të caktuar. Kjo na tregon edhe nivelin e përgatitjes që ka një terrorist, i cili sakrifikon edhe veten e tij për qëllimin e madh.

Për ta përmbledhur më qartë dhe saktë do të shënohen në pika dallimet e këtyre vrasësve.

- I pari vepron në vetmi të plotë - I dyti në grup
- I pari kryen vrasjen për qejf – I dyti e merr si detyrë
- I pari kërkon vazhdimësinë - I dyti kërkon lavdinë
- I pari i ikë përgjegjësisë dhe fsheh faktet - I dyti del haptazi dhe pranon krimin

Janë këto disa dallime dhe veçori që na tregojnë shumë për mënyrën se si funksionon truri i terroristit dhe na ndihmojnë në kuptimin e botës së tyre duke na mundësuar edhe zbërthimin e aktit të tyre dhe kuptuar arsyen e vërtetë.

⁷³<https://www.crimemuseum.org/2014/06/23/9-early-warning-signs-for-serial-killers-2/>

3.3 NDIKIMI I MEDIAVE NË PERCEPTIMIN E KËRCËNIMIT TË TERRORIZMIT

Mediat dhe masmediat kanë fituar një rol shumë të fuqishëm në jetën e përditshme dhe kuptimin që kemi për botën që na rrethon. Falë edhe rrjeteve të ndryshme sociale që janë shndërruar në burime të informacionit dhe lajmeve të rreme dhe numri i përdoruesve të tyre është jashtëzakonisht i madh, atëherë kuptojmë me të vërtetë se çfarë ndikimi kanë mediat jo vetëm në perceptimin e terrorizmit, por të gjithë botës që na rrethon.

Shtrohet pyetja, cili është roli i medias?

Por pyetja tjetër është, çfarë është informata?

Njohuritë që merren për dikë ose diçka: fakte ose detaje për një temë ⁷⁴

Më herët është cekur procesi i shpërlarjes së trurit dhe kemi thënë që mënyra e vetme për të arritur këtë qëllim është bombardimi me informacione te truri i njeriut, ndaluni dhe mendoni se sa informacione mund të merren në ditët e sotme në momentin që hapni televizorin, telefonin apo edhe kompjuterin tuaj. Lumi i informatave që ju vërshojnë është i pafund. Informata rreth kohës, motit, ngjarjeve të ditës, një fatkeqësie natyrore që ka ndodhur 3000 km larg nesh ose edhe më larg, të gjitha këto në kohë reale.

Por përveç këtyre ka edhe informata të rreme të cilat qarkullojnë dhe përhapen shumë më shpejt se ato të vërtetat dhe kanë tendencën që të besohen më shumë se ato të vërtetat dhe duke mos harruar të përmendet që shumica e përdoruesve dhe lexuesve të këtyre lajmeve të rreme e pranojnë gjithë informacionin si të saktë duke mos dyshuar për asnjë moment për vërtetësinë e tij.

Dihet që qëllimi i një akti terrorist është ngjallja e pasigurisë, panikut dhe frikës tek popullata. Ky qëllim me anën e mediave po shumëfishohet dhe po arrin përmasa jashtë normales.

⁷⁴<https://www.merriam-webster.com/dictionary/information>

KAPITULLI IV

4. E ARDHMJA

Thuhet se ardhmja nuk dihet se çka rezervon dhe se çfarë na pret. Në shumicën e rasteve është e vërtetë andaj edhe duhet pranuar si e tillë.

Por në fushën e sigurisë kjo thënie mund të gjejë shumë pak vend dhe përdorim. Asnjë shtet nuk mund të rri duarkryq dhe të presë se çfarë do të ndodhë, sepse atëherë do të jetë shumë vonë.

Shtetet e mirëfillta që kanë një traditë të udhëheqjes dhe ekzistencës, kanë një mënyrë të funksionimit që lë shumë pak vend për të papritura dhe befasi.

Kjo arrihet në bazë të planifikimit paraprak të të gjitha proceseve dhe vendimeve.

Ato variojnë nga shkalla e rëndësisë dhe nevojshmërisë. Kjo mënyrë planifikimi ndahet në tre hapa.

Këta hapa janë:

-Taktik

-Operacional

-Strategjik

Njëra pa tjetrën nuk bëjnë asses, prandaj është shumë me rëndësi që këto plane të bashkërendohen në mënyrë që të arrihet sukses.

Për ata që nuk e kanë të qartë se çfarë nënkuptojnë këta tre hapa të planifikimit, do të sqarohen shumë shkurt dhe thjesht.

Vetë mënyra se si janë renditur janë nga niveli më i ulët tek ai më i madhi.

Çdo veprim që bëhet, siç është shembulli më i thjeshtë, patrollimi i policisë nëpër rrugë ose lagje, është një veprim taktik i cili përsëritet çdo ditë dhe ka për qëllim krijimin e një fryme sigurie tek qytetarët. Në vende si Kosova dhe rajoni ka shumë punë për t'u bërë në aspektin e sigurisë, prandaj duhet një plan i mirë menduar dhe planifikuar që kjo të realizohet. Sepse nëse nuk ke një plan strategjik në këtë rast, atëherë edhe nuk ke dijeni se nga do t'i drejtosh fuqitë dhe energjitë mbrojtëse.

4.1 EVOLUIMI I SULMEVE TERRORISTE

Asgjë nuk mbetet gjithmonë e njëjtë, as vetë njeriu. Ai plakët dhe ndryshon në shumë aspekte. Bashkë me njeriun ndryshon edhe ambienti dhe fenomenet rreth tij.

As terrorizmi nuk ka mbetur i njëjtë, sepse edhe mjetet dhe teknologjia kanë evoluar dhe janë përsosur.

Në kohët e hershme ishte e kushtëzuar që për të kryer një akt terrorist të ketë prezencë fizike të personit, ku edhe sot e kësaj dite kemi raste të grupeve të vogla dhe individëve që kryejnë sulme personale, qofshin ato kamikaze ose vrasje masive, por këto janë sulme, niveli dhe planifikimi i të cilave është shumë i thjeshtë për të mos thënë pa plan.

Jo vetëm niveli i funksionimit, por edhe struktura bashkë me veprimtarinë kanë ndryshuar shumë.

Në mesjetë grupet terroriste ishin shumë më ekskluzive dhe anëtarësimi në këto grupe ishte shumë i vështirë sepse duhej që kauza e atij grupi të përqafohej plotësisht. Veprimtaria e tyre kësaj ishte shumë sekrete.

Pjesë shumë e rëndësishme e grupeve terroriste është edhe financimi sepse nuk mund të zhvillohen projekte madhore pa përkrahje financiare, sidomos në ditët e sotme.

Por në kohët më të vjetra dhe deri në kohën e revolucionit francez, kohë kur edhe lind termi terrorizëm, financimin e grupeve terroriste e kryenin vetë anëtarët ose ka pasur edhe raste kur

aristokratë të ndryshëm, të cilët ishin kundër udhëheqësisë së vendit dhe mënyrës si qeverisin, krijojnë trazira të vogla dhe revolta në popull, të cilat gradualisht marrin përmasa të mëdha.

Kjo ishte edhe mënyra se si ndodhi revolucioni francez dhe të gjithë i dimë pasojat e atij revolucioni.

Fjala angleze "terrorizëm" vjen nga regjimi de la terreur që mbizotëroi në Francë nga 1793-1794. Fillimisht një instrument i shtetit, regjimi ishte projektuar për të konsoliduar pushtetin e qeverisë revolucionare të sapo-instaluar, duke e mbrojtur atë nga elemente të konsideruar "subversivë". Terrorizmi ishte gjithmonë i ngarkuar me vlera, fillimisht, një term pozitiv.

Udhëheqësi revolucionar francez, Maximilien Robespierre, e shihte si jetike nëse Republika e re Franceze do t'i mbijetonte fillimet e saj, duke shpallur në 1794 se: "Terrori nuk është asgjë tjetër veçse drejtësi, i shpejtë, i ashpër, i papërkullor; prandaj është një emanacion i virtytit; nuk është asnjë parim i veçantë, sa është pasojë e parimit të përgjithshëm të demokracisë që zbatohet për nevojat më urgjente të vendit tonë."⁷⁵

4.2 TEKNOLOGJIA DHE TERRORIZMI

Ndër temat më të debatuar në dekadën e fundit padyshim është teknologjia.

Nuk ka sferë të jetës që ajo nuk e ka ndikuar dhe ndryshuar. Prandaj edhe tek terrorizmi kjo ka pasur ndikim pozitiv, por që për ata që e luftojnë nuk mund ta themi të njëjtën.

Gjatë rrjedhës së Luftës kundër Terrorizmit, ekspertët kanë identifikuar kushtet politike dhe socio-ekonomike si shkaqet kryesore të terrorizmit. Megjithatë, mundësitë teknologjike që bëjnë të mundur terrorizmin janë më pak të studiuara. Inovacionet në informatikë dhe telekomunikacion – si akses i përhapur në internet, enkriptimi nga fundi në fund, dhe përdorimi

⁷⁵<https://www.pogo.org/investigation/2015/02/brief-history-of-terrorism/>

i rrjetit privat virtual (VPN)– kanë bërë të mundshme lloje të reja operacionesh për një numër më të madh individësh të radikalizuar.

Shteti Islamik ka kapitalizuar më së miri në peizazhin e ri të drejtuar teknologjikisht duke frymëzuar dhe drejtuar sulme nga distanca. Këto operacione kërkojnë pak trajnim ose planifikim taktik, përfshijnë mjete të papërpunuara – si thika ose makina – dhe mund të kryhen nga kushdo, kudo. Kombinimi i operacioneve të thjeshta dhe kapaciteti i rritur komunikues e ka bërë terrorizmin të aksesueshëm për masat.⁷⁶

Kur flasim për terrorizmin fetar islamik, procedura ka qenë e tillë, që udhëheqësit fetarë kanë qenë edhe udhëheqësit e indoktrinimit të popullatës. Ka një arsye se përse terrorizmi islamik është kaq radikal, efikas dhe kundër vlerave demokratike dhe kjo mund të sqarohet vetëm me një shpjegim psikologjik.

Në rastin e terrorizmit islamik, udhëheqësit arrijnë me shumë mjeshtri që të manipulojnë diçka shumë të shenjtë për besimtarët musliman, ai është libri i shenjtë i tyre Kur'an-i dhe ligji i sheriatit. Duke i ndarë disa fragmente të caktuara dhe keqinterpretuar ato tek masa e gjerë, që vlen të ceket se analfabetizmi te këto vende është mbi 50%, Afganistani ka një shkallë prej 65.5% të popullatës analfabete⁷⁷.

Dhe kjo tregon se shumica e popullatës e marrin informacionin e gatshëm duke mos qenë në gjendje që ta analizojnë, krahasojnë dhe vlerësojnë vërtetësinë e tij.

Kësaj i shtohet faktori teknologjik që mundëson përhapjen e idesë dhe mendimit të një personi tek të tjerët shumë më shpejt.

Shumica e kompanive teknologjike e kanë të rregulluar formën e shprehjes dhe shpesh cenzurojnë dhe bllokojnë persona të ndryshëm që promovojnë gjuhën e urrejtjes. Siç është rasti me Twiter i cili bllokoi llogarinë e ish-Presidentit Trump i cili nxiti demonstratat e dhunshme datën e 6 janarit 2020.

⁷⁶<https://www.csis.org/npfp/evolving-tech-evolving-terror>

⁷⁷<https://uil.unesco.org/interview-literacy-rate-afghanistan-increased-43-cent>

Por black web apo si përkthehet në shqip rrjeti i zi, nuk ka kontrollë dhe është shumë vështirë i gjurmueshëm, ka potencialin shkatërrues sepse në të kanë qasje nga e gjithë bota dhe në dekadën e fundit kemi rritje të rasteve të tilla që pasi zbulohet e vërteta, kuptohet që radikalizimi është bërë nga interneti, dhe si shembull më të freskët kemi sulmin terrorist në Norvegji nga shtetasi danez i konvertuar në fenë islame.

Sulmet terroriste shpesh koreografikohen me kujdes për të tërhequr vëmendjen e medias elektronike dhe shtypit ndërkombëtar. Terrorizmi ka për qëllim njerëzit që shikojnë, jo viktimat aktuale. Terrorizmi është një teatër,” shkroi Brian Jenkins, një ekspert i terrorizmit ndërkombëtar. Ekspertët shpjeguan se në vitin 1998 numri i faqeve të internetit që përmbanin materiale terroriste ishte 12, në vitin 2003 ai numëronte 2650 faqe interneti dhe në shtator 2015 numri i përgjithshëm ka arritur në 9800.⁷⁸



79

Interneti, dhe në përgjithësi teknologjia, mund të shfrytëzohet nga organizatat terroriste për disa qëllime, duke përfshirë:

-Propaganda

-Lufta psikologjike


-Rekrutimi dhe mobilizimi

⁷⁸<https://resources.infosecinstitute.com/topic/the-role-of-technology-in-modern-terrorism/>

⁷⁹<https://resources.infosecinstitute.com/topic/the-role-of-technology-in-modern-terrorism/>

- Mbledhja e fondeve
- Miniera e të dhënave, mbledhja e informacionit
- Komunikime të sigurta
- Sulmet kibernetike
- Shpërndarja e softuerit (p.sh., aplikacioni celular)
- Blerja e dokumenteve false
- Trajnimi⁸⁰

Një ndër aspektet më të forta është propaganda dhe fotoja në vijim do ta sqarojë më mire këtë, pa qenë nevoja për të shtuar më shumë.



81

Platformat dhe forumet e mediave sociale përdoren nga organizatat terroriste për të shkëmbyer materiale propaganduese dhe trajnimi.

⁸⁰<https://resources.infosecinstitute.com/topic/the-role-of-technology-in-modern-terrorism/>

⁸¹<https://resources.infosecinstitute.com/topic/the-role-of-technology-in-modern-terrorism/>

Mediat sociale janë një instrument i privilegjuar i propagandës; kjo do të thotë se duke i analizuar ato është e mundur të ndiqen ngjarjet dhe vendndodhja e tyre gjeografike.

Country	January	February	% increase	Absolute increase
EGYPT	38 213	184 588	483%	146 375
UNITED ARAB EMIRATES	12 219	45 651	374%	33 432
ISRAEL	4 848	17 668	364%	12 820
JORDAN	5 457	19 118	350%	13 661
MICRONESIA, FEDERATED STATES OF	11 318	38 998	345%	27 680
ERITREA	9 648	30 556	317%	20 908
PALESTINIAN TERRITORY	11 020	33 860	307%	22 840
GEORGIA	2 113	6 488	307%	4 375
TUNISIA	2 701	8 018	297%	5 317
OMAN	3 256	9 119	280%	5 863
MALTA	3 420	8 301	243%	4 881
BERMUDA	2 834	6 809	240%	3 975
MOROCCO	2 058	4 858	236%	2 800
BAHRAIN	12 789	29 953	234%	17 164
YEMEN	6 122	13 749	225%	7 627
SAUDI ARABIA	160 505	328 752	205%	168 247
UNITED STATES	7 615	14 994	197%	7 379
IRAQ	22 452	39 030	174%	16 578
UNITED KINGDOM	13 764	21 981	160%	8 217
LEBANON	18 613	28 483	153%	9 870
SYRIAN ARAB REPUBLIC	9 591	13 954	145%	4 363
KUWAIT	54 927	63 167	115%	8 240
QATAR	32 871	18 587	57%	-14 284
GUINEA-BISSAU	25 441	8 734	34%	-16 707

FOTO: Tweetet në lidhje me Shtetin Islamik (shkurt 2015 – Burimi: Recorded Future)⁸²

Interneti është një minierë për terroristët, ai përfshin informacione të çmuara që mund të përdoren nga terroristët për të sulmuar caqe specifike. Analiza e Burimeve të Hapura i lejon sulmuesit të mbledhin të dhëna për objektivat dhe të lejojnë terroristët të kryejnë një zbulim pasiv.⁸³

⁸²<https://resources.infosecinstitute.com/topic/the-role-of-technology-in-modern-terrorism/>

⁸³<https://resources.infosecinstitute.com/topic/the-role-of-technology-in-modern-terrorism/>



FOTO: Cybernetic Magazine (ISIS)

⁸⁴Cybernetic Magazine (ISIS)

4.3 TERRORIZMI DHE KRIMI I ORGANIZUAR

Pishtarët e studimeve të sigurisë janë mësuar që këto dy probleme t'i trajtojnë si pjesë të ndara. Karakteristikat e tyre kanë qenë të ndara nga një vijë e drejtë e cila nuk ka mundur të kalojë.

Por zhvillimet e dy dekadave të fundit kanë hapur rrugën për ndryshime në shumë aspekte të jetës. Jemi dëshmitarë edhe vetë se si shekulli XXI është një rast studimi në vete. Ngjarje dhe arritje që konsideroheshin fantastiko-shkencore në shekullin XX, tani janë pjesë e përditshmërisë tonë.

Sot më shumë se kurrë, krimi i organizuar ndërkombëtarisht është më i zhvilluar dhe lidhur me botën. Shtrirja e tij është aq e madhe sa që mund të krahasohet me shumë organizata botërore.

KRIMI I ORGANIZUAR

Çdo akt dhune dhe kriminal i kryer nga tre e më tepër persona dhe që si qëllim kryesor ka përfitimin material (para) konsiderohet si krim i organizuar.

Ky lloj krimi është i një niveli tjetër sepse nuk kategorizohet si krim ordiner. Për zbatimin e këtyre veprimtarive kriminale duhet ndjekur një rrugë dhe mënyrë veprimi që përfshinë shumë ingranazhe që nuk varen drejtëpërdrejtë nga një person, por nga një rrjet i madh njerëzish të cilët kanë detyra të deleguara në mënyrë specifike.

Tradicionalisht njerëzit që janë marrë me krimin e organizuar kanë qenë persona që kanë vështirësi ekonomike dhe rruga më e lehtë për të siguruar mirëqenien sociale ishte krimi.

Këto grupe kriminale kanë një udhëheqës fjala e të cilit është ligj, dhe asnjëherë nuk vihen në dyshim. Struktura organizative është e tillë që udhëheqësi asnjëherë nuk merret me punët e pista drejtëpërdrejtë sepse këto detyra delegohen tek persona që janë vartës të kryeshefit.

Aktivitet më të cilat merren këto grupe kanë qëllim të pastër ekonomik prandaj aktivitet e tyre orientohen në kontrabandimin e mallrave me vlerë, prostitucion, lojërat e fatit, reketi, ryshfeti, fajdet dhe shumë vonë filluan grupet tradicionale kriminale që fillon me kontrabandën e narkotikëve sepse kjo tërhoqte shumë vëmendje nga autoritet shtetërore.

Por shumë shpejt kjo ndryshoi kur ato kuptuan fitimet marramendëse që kishin, prandaj ato u specializuan vetëm në trafikimin e narkotikëve.

Ka raste të shumta kur persona të tillë janë renditur edhe në mesin e personave më të pasur në botë falë fitimeve me narkotikë.

Ajo se çka e ka dalluar shumëkrimin e organizuar dhe aktet terroriste ka qenë fusha e veprimit. Krimi i organizuar e ka të pamundur funksionimin pa krijuar lidhje me shtetin, më saktë me zyrtarët shtetërorë që mundësojnë zhvillimin e aktiviteteve ilegale pa u shqetësuar.

Terrorizmi gjithmonë ka qenë i vetëm në rrugëtimin e tij drejt arritjes së qëllimit sepse natyra e tij e fushëveprimit minon veprimtarinë e shtetit dhe në këtë drejtim shteti nuk fiton asgjë, por vetëm i shtohet fatura e dëmeve.

Si gjithçka që evoluon edhe krimi ka ndryshuar me kalimin e kohës.

Ajo çfarë po shqetëson shumë studiuesit e sigurisë është transformimi dhe hibridizimi i këtyre dy veprimeve ilegale.

Deri vonë e vetmja lidhje mes këtyre dy veprimtarive ishte tregtia e armëve edhe pajisjeve tjera që ndihmonin në arritjen e qëllimit terrorist. Në anën tjetër krimi i organizuar nuk interesohej edhe shumë për të mos thënë fare se kujt i shiste armë.

Megjithatë asgjë nuk qëndron ashtu siç është, sikur krimi i organizuar dhe terrorizmi kanë filluar të shohin fitimet që mund të kenë duke kryqëzuar shpesh rrugët njëra me tjetrën.

Për krimin e organizuar është më profitabile që një vend të zhvillojë luftë sepse në plan të parë fiton me shitjen e armëve, pastaj lufta sjellë edhe një gjendje të jashtëzakonshme kur shteti nuk ka më kontroll të plotë dhe mbizotëron një anarki, çka krimi i organizuar e ëndërron ditë e natë për një situatë të tillë.

Terroristët dhe kryengritësit po i drejtohen gjithnjë e më shumë krimit të organizuar për të gjeneruar fonde dhe për të marrë mbështetje logjistike për të kryer aktet e tyre të dhunshme. Departamenti i Drejtësisë raporton se 29 nga 63 organizatat në listën e objektivave të Organizatës Prioriteti të Konsoliduar të VF 2010, e cila përfshin organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare të trafikut të drogës (DTO) që kërcënojnë Shtetet e Bashkuara, ishin të lidhura me grupe terroriste. Përfshirja në tregtinë e drogës nga talebanët dhe Forcat e Armatosura Revolucionare të Kolumbisë (FARC) është kritike për aftësinë e këtyre grupeve për të financuar aktivitetin terrorist.

Ne jemi të shqetësuar për aktivitetet e drogës dhe kriminale të Hizbollahut, si dhe për indikacionet e lidhjeve midis al-Ka'idës në Tokat e Magrebit Islamik dhe tregtisë së drogës. Më tej, organizata terroriste al-Shabaab është përfshirë në aktivitete kriminale si rrëmbimi për shpërblim dhe zhatje, dhe mund të nxjerrë tarifa të kufizuara nga zhatja ose mbrojtja e piratëve për të gjeneruar fonde për operacionet e saj.

Ndërsa lidhja krim-terror është ende kryesisht oportuniste, kjo lidhje është megjithatë kritike, veçanërisht nëse do të përfshinte transferimin e suksesshëm kriminal të materialeve të armëve luftarake kundër terroristëve ose depërtimin e tyre në rrjetet e kontrabandës njerëzore si një mjet për terroristët që të hyjnë në Shtetet e Bashkuara.⁸⁵

Një element kyç i përbashkët në shtrëngimin bindës politik dhe kriminal është 'frikësimi'.

Grupet e krimit të organizuar përdorin dhunë ndaj shitësve apo pronarëve të restoranteve 'jo bashkëpunëtorë' me qëllim që të frikësojnë pronarët e bizneseve të tjera në territorin e tyre dhe t'i bindin ata të paguajnë 'paratë e mbrojtjes' për të mos u viktimizuar gjithashtu.

Terroristët shpesh përfshihen në zhatje të ngjashme me akte të frikësimit të detyruar me qëllim që të mbledhin 'taksat revolucionare'. Në të dyja rastet, një viktimë instrumentale shërben për të manipuluar një target grup më të gjerë. Sapo disa që kanë refuzuar të paguajnë janë vrarë, të tjerët do të mendojnë dy herë për ta luajtur rolin e heroit. Ndërsa ka dallime të qarta midis

⁸⁵<https://obamawhitehouse.archives.gov/administration/eop/nsc/transnational-crime/threat>

kriminelëve të zakonshëm dhe terroristëve politikë – një kriminel i zakonshëm, për shembull, nuk do të përfshihej kurrë në një sulm vetëvrasës – ka gjithashtu ngjashmëri:

- Të dyja operojnë fshehurazi dhe zakonisht nga një nëntokë.
- Të dyja përdorin 'muskuj' dhe pamëshirshmëri, dhe viktimat e tyre janë kryesisht 'civile'.
- Frikësimi është karakteristik për të dyja grupet.
- Të dyja përdorin taktika të ngjashme (megjithëse jo tërësisht të mbivendosura): rrëmbime, vrasje, zhatje për 'paratë e mbrojtjes', 'taksat revolucionare'.
- Në të dyja rastet, kontrolli i 'grupit të babëzitur' mbi një anëtar individual është i fortë.
- Të dyja përdorin organizata të para si biznese legjitime ose bamirësi⁸⁶

Nuk mund të mohohet se ka edhe dallime të rëndësishme:

- Grupet terroriste zakonisht janë të motivuara ideologjikisht ose politikisht, ndërsa grupet e krimit të organizuar janë të orientuara drejt fitimit.
- Grupet terroriste shpesh dëshirojnë të konkurrojnë me qeveritë për legjitimitet; derisa grupet e krimit të organizuar nuk e bëjnë.
- Grupet terroriste zakonisht pëlqejnë vëmendjen e medias; grupet e krimit të organizuar jo.
- Viktimizimi i terrorizmit është përgjithësisht më pak diskriminues sesa dhuna e përdorur nga krimi i organizuar⁸⁷

Në realitet, ka organizata hibride dhe qëllime të dyfishta ndaj akteve të dhunës. Një rrëmbim mund të shërbejë si për të zhvatur lëshime politike ashtu edhe për të mbledhur para për shpërblësë kriminale. Ted Gurr, në përgjigjen e tij ndaj pyetësorit, vuri në dukje edhe këtë dilemë:

⁸⁶The Routledge Handbook of Terrorism Research by Alex P.Schmid (2011,faqe 65-67)

⁸⁷ The Routledge Handbook of Terrorism Research by Alex P.Schmid (2011,faqe 65-67)

Autori Alex P. Schmid shpreh pasigurinë e tij me definimin se terrorizmi përdoret si një mjet që ka qëllime politike sepse shpesh terrori është përdorur edhe si mjet për arritjen e fitimeve materiale.

Nëse një lëvizje ose rrjet ka objektiva ekonomike dhe politike, dhe përdor terrorin/ushton ndikim si në sferën ekonomike ashtu edhe në atë politike, si ta ndajmë rëndësinë relative të dy objektivave të ndryshëm?

Dhe rast të vërtetë kemi narko-kartelet kolumbiane të cilat krijuan një frymë terrori dhe frike për vite me radhë, me qëllim ruajtjen e monopolit të drogës dhe kontrollit të shtetit.⁸⁸

⁸⁸ The Routledge Handbook of Terrorism Research by Alex P.Schmid (2011,faqe 66)

PËRFUNDIM

Terrorizmi është një fenomen që po pëson ndryshime me kalimin e çdo dite, por që formën elementare e ka ende në përbërje. Vazhdon një akt i cili ka për qëllim ndjelljen e frikës dhe destabilitetit. Por mjetet me të cilat ai po i arrin qëllimet kanë evoluar dhe ndryshuar. Duke pasur parasysh një botë e cila është e varur thajse tërësisht nga teknologjia, grupet terroriste kanë filluar që ta luajnë në anën e tyre këtë mundësi e cila është një oqean i thellë. Mundësitë që më herët as që kanë ekzistuar, tani janë hapur dhe janë aty.

Sipas një raporti, një nga tendencat më shqetësuese në pesë vitet e fundit është rritje e terrorizmit politik të ekstremit të djathtë, edhe pse absolut numri i sulmeve të ekstremit të djathtë mbetet i ulët në krahasim me format e tjera të terrorizmit.⁸⁹

Ka disa shenja se dhuna politike po bëhet më e pranueshme publikisht, pasi niveli i polarizimit në shoqëri vazhdon të rritet. Rol të madh në këtë polarizim po luan media dhe masmedia e cila asnjëherë si kurrë më parë po përhap informacionin i cili nuk është tërësisht i saktë dhe kjo ndikon në keqperceptimin e problemit.

Për të qenë sa më efikas duhet që në të njëjtin hap me evoluimin e terrorizmit edhe format e luftimit të evoluojnë sepse nuk ka zgjidhje tjetër. Duhet që në fokus të jetë evidentimi dhe parandalimi i sulmeve terroriste përmes teknologjisë, por edhe psikologjisë.

Nëse deshirojmë që të kapim një kriminel atëherë duhet të mendojmë si një i tillë. E njëjta vlen edhe për terrorizmin. Duhet që të jemi në gjendje të parashikojmë skenare të ndryshëm se si një sulm terrorit mund të ndodhë, kur, ku dhe pse. Të gjitha këto së bashku me përdorimin e teknologjisë mund të arrihen në një nivel të kënaqshëm.

⁸⁹<https://www.economicsandpeace.org/wp-content/uploads/2020/11/GTI-2020-web-2.pdf>

REKOMANDIME

Terrorizmi nuk është një fenomen i izoluar vetëm në një vend. Ai ka prekur gjithë botën, duke e shndërruar në një problem global të sigurisë. Prandaj shtrohet nevoja që një problemi global t'i qasemi në mënyrë globale. Bashkëpunimi duhet të jetë në një nivel të paprecedentë si në mes shteteteve por edhe në mes organizatave të ndryshme që kanë për qëllim luftën ndaj terrorizmit. Zhvillimet dhe zbulimet e reja duhet që të bëhen të qasshme për të gjithë në mënyrë që të gjithë të kemi qasje të barabartë.

Sa i përket nivelit individual, të gjithë ata që do të vendosin që t'i kushtojnë jetën e tyre studimeve të sigurisë dhe dilemave e problemeve që ka kjo fushë, këshilloj që fokus të veçantë t'i kushtohet aspektit psikologjik, sepse çelësi i së vërtetës ndodhet tek psikologjia, e cila falë edhe teknologjisë, por edhe përkushtimit të njeriut për ta kuptuar njeriun ka arritur të hedhë dritë në shumë probleme që kanë qenë së pari të pamenduara që mund t'i zgjidhë, por edhe ka hedhur dritë tek fenomene që nuk kemi pasur as edhe një ide që ekzistojnë.

Sa i përket Kosovës, ajo duhet që të zhvillojë kuadrot e saj brenda dekadës së ardhshme dhe të bëjë një investim në drejtim të kësaj pune, urgjente madje. Sepse nuk mjafton vetëm një akademi shtetërore për të ofruar sigurinë e nevojshme. Gjithashtu, në fokus të veçantë duhet të ketë që gjatë kësaj kohe të fitojë mbështetjen e sa më shumë aleatëve dhe të kërkojë ndihmën e tyre, por në të njëjtën kohë edhe të bashkëpunojë dhe fitojë eksperiencën e duhur.

LITERATURA

1. The Routledge Handbook of Terrorism Research **by Alex P. Schmid (Ed.)**
2. Ghost Wars The Secret History of the CIA, Afghanistan, and bin Laden, from the Soviet Invasion to September 10, 2001 **by Steve Coll**
3. Who Becomes a Terrorist and Why The Psychology and Sociology of Terrorism **by Rex A. Hudson**
4. The Psychology of Criminal and Antisocial Behavior. Victim and Offender Perspectives **by Wayne Petherick and Grant Sinnamon**
5. Criminal psychology **by David V Canter**
6. Brainwashing The Science of Thought Control **by Kathleen Taylor**
7. The History of Terrorism From Antiquity to al Qaeda **by Gérard Chaliand, Arnaud Blin**
8. Understanding Terror Networks **by Marc Sageman**
9. Lufta Psikologjike-**Nevzat Tarhan**
10. Geghis Khan dhe Krijimi i Botës moderne-**Jack Weatherford**
11. The Killer Across the Table:Unlocking the Secret of Serial Killers and Predators with The FBI's Original MindHunter
12. **Misha Glenny**, Krimi Kibernetik (Si u bënë hakerët mafia e re), Botimet Pena, Prishtinë, 2019.
13. **Ragip Halili**- Kriminologjia, 2000
14. Studime Bashkëkohore të Sigurisë, 2006, **Allan Collins**
15. Putin's People, How KGB Took Back Russia and Then Took Back On The West, 2020-**Catherine Belton**
16. Global Terrorism Index, 2020-**Institute for Economics and Peace**

DOKUMENTAR

1.MindHunter

2.Man Hunt:UnaBomber

3.The Forever Prisoner

4.9/11 (2002)

5.Terrorism Close Calls

LINQE NGA INTERNETI

1. <https://www.britannica.com/topic/terrorism>
2. <https://www.pogo.org/investigation/2015/02/brief-history-of-terrorism/>
3. <https://www.healthline.com/health/mental-health/fight-flight-freeze>
4. <https://www.britannica.com/topic/religion>
5. <https://www.verywellmind.com/religion-improves-health-2224007>
6. <https://cartoonmovement.com/cartoon/terrorism-brainwashing>
7. <https://www.theguardian.com/world/2001/may/29/qanda.janeperrone>
8. https://techcrunch.com/2015/08/03/uncovering-echelon-the-top-secret-nsa-program-that-has-been-watching-you-your-entire-life/?guccounter=1&guce_referrer=aHR0cHM6Ly93d3cuZ29vZ2xlLmNvbS8&guce_referrer_sig=AQAAAJ-g0tY0mn5GL2SwrR9Yrn-CpdTfJ0lqGRV9k12twP8ArXv-7pm4Fro-JB8ij5XU1zt54CDemPnsrDipOyZSFN66ZohdhUTMGUMmiKwx6HqsjkePsQt_bjfivGm5ZMD0MOjvpaCmA3fBQ7wGgfvAORUKEHJAfLe3XJgG5a-qgQAe
9. <https://www.history.com/topics/21st-century/9-11-attacks>
10. <https://www.nytimes.com/2019/12/04/us/politics/cia-torture-drawings.html>

11. <https://www.whitehouse.gov/briefing-room/statements-releases/2021/06/15/fact-sheet-national-strategy-for-countering-domestic-terrorism/>
12. https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/716907/140618_CCS207_CCS0218929798-1_CONTEST_3.0_WEB.pdf
13. <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/46/STRATEGJIA%20SHTET%C3%8BRORE%20KUND%C3%8BR%20TERRORIZMIT%20DHE%20PLANI%20I%20VEPRIMIT%202018%20%E2%80%93%202023.pdf>
14. <https://dema.az.gov/sites/default/files/Publications/AR-Terrorism%20Definitions-BORUNDA.pdf>
15. <https://www.crimemuseum.org/2014/06/23/9-early-warning-signs-for-serial-killers-2>
16. <https://www.csis.org/npfp/evolving-tech-evolving-terror>
17. <https://uil.unesco.org/interview-literacy-rate-afghanistan-increased-43-cent>
18. <https://www.oxygen.com/kemper-on-kemper-inside-the-mind-of-a-serial-killer/crime-time/shocking-interviews-ed-kemper>
19. <https://www.merriam-webster.com/dictionary/information>
20. Cybernetic Magazine (ISIS)
21. <https://resources.infosecinstitute.com/topic/the-role-of-technology-in-modern-terrorism/>
22. https://www.diplomatie.gouv.fr/IMG/pdf/critik_psychoterrorisme.pdf